



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 92

Tiranë – E premte, 23 qershor 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 84, datë 19.6.2023	Për dhënien e shtetësisë shqiptare..... 9721
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 7.6.2023	Për disa shtesa në ligjin nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat” 9721
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 21.6.2023	Për disa ndryshime në aktin normativ nr. 1, datë 20.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS)”, miratuar me ligjin nr. 23/2019..... 9721
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 21.6.2023	Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në ABYEI (UNISFA)..... 9722
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 370, datë 21.6.2023	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Durrës, të pasurive nr. 2/235, 2/238, 2/371 dhe 4/131, zona kadastrale 8514, Durrës..... 9722
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 21.6.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 270, datë 2.5.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS)”, të ndryshuar..... 9728
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 372, datë 21.6.2023	Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar..... 9728
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 373, datë 21.6.2023	Për një shtesë në vendimin nr. 1497, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për shtypjen e letrave me vlerë”, të ndryshuar..... 9742

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 374, datë 21.6.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 429, datë 12.9.2002, të Këshillit të Ministrave, “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore”, të ndryshuar.....	9742
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 375, datë 21.6.2023	Për shfuqizimin e vendimit nr. 160, datë 14.3.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për reduktimin e shpenzimeve të transportit për funksionarët, nëpunësit, punonjësit e institucioneve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave dhe shoqërive/ndërmarrjeve me kapital shtetëror”.....	9744
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 376, datë 21.6.2023	Për dhënien e miratimit për fillimin e procedurave të privatizimit për pronën nr. 338, me emërtim “Ish-reparti ushtarak nr. 5012/20”, me vendndodhje në Çekrez, Gramsh, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, dhënë me qira me tarifën 1 euro/kontrata shoqërisë “Roza” sh.p.k.....	9745
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 377, datë 21.6.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 228, datë 13.4.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, miratuar për Ministrinë e Kulturës, për financimin e Festivalit Folklorik Kombëtar Gjirokastrë, 24 qershor–2 korrik 2023”.....	9745
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 10, datë 16.6.2023	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 52, datë 3.12.2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.....	9746
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 16, datë 16.6.2023	Për mënyrën e zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.5.2023, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”.....	9746
Urdhër i ministrit të Brendshme nr. 85, datë 16.6.2023	Për delegimin e kompetencave.....	9750
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 412, datë 16.6.2023	Për delegim kompetence.....	9750
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 27, datë 18.5.2023	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 880, datë 23.4.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2022-1130, datë 13.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit.....	9750
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 28, datë 18.5.2023	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-2166 (79), datë 7.3.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	9758

Kërkesë e Agjencisë Shtetërore
për Shpronësimin nr. 365/7,
datë 20.6.2023

Për shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Krijimi i një parkimi makinash pranë Urës së Vjetër të Goricës”.....	9769
Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen e vdekjes së shtetasit Viktor Sharko...	9771
Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasës Leme Dibra.....	9771



DEKRET
Nr. 84, datë 19.6.2023

PËR DHËNIEN E SHQIPTARË
SHQIPTARË

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, të nenit 93 të Kushtetutës; nenit 8, si dhe nenit 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënie e shtetësisë shqiptare shtetasit të mëposhtëm:

- Mirlind Fehmi Daku

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

AKT NORMATIV
Nr. 2, datë 7.6.2023

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN
NR. 29/2023, “PËR TATIMIN MBI
TË ARDHURAT”

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Pas pikës 3, të nenit 69, “Dispozita kalimtare”, të ligjit nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, shtohen pikat 4 dhe 5, me këtë përmbajtje:

“4. Përfshirja e parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, tatimpaguesit, eksportues të mallrave në regjimin e përpunimit aktiv, të cilët

në vitin 2022 kanë eksportuar jo më pak se 70% të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet, nuk paguajnë këstet që parapaguhën në muajt qershor, shtator dhe dhjetor të vitit 2023.

5. Deri në datën e fillimit të efekteve të këtij ligji, sipas përcaktimit të nenit 72 të tij, zbatohen parashikimet e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

AKT NORMATIV
Nr. 3, datë 21.6.2023

PËR DISA NDRYSHIME NË AKTIN
NORMATIV NR. 1, DATË 20.3.2019, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PJESËMARRJEN E PERSONELIT TË
FORCËVE TË ARMATOSURË TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
MISIONIN E KOMBEVE TË BASHKUARA
NË SUDANIN E JUGUT (UNMISS),
MIRATUAR ME LIGJIN NR. 23/2019

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në aktin normativ nr. 1, datë 20.3.2019, të Këshillit të Ministrave, miratuar me ligjin nr. 23/2019, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1, togfjalëshi “... 2 (dy) ...” zëvendësohet me “... 3 (tre) ...”.

Neni 2

Në nenin 2, fjalët “... kryeqytet i Republikës së Sudanit të Jugut.”, zëvendësohen me “... si dhe në Shtabin e Komandës Bor, Jonglei, në Sudanin e Jugut.”



Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

AKT NORMATIV
Nr. 4, datë 21.6.2023

PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT
TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
MISIONIN E KOMBEVE TË
BASHKUARA NË ABYEI (UNISFA)

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Pjesëmarrjen e 1 (një) ushtaraku të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në Abyei (UNISFA).

Neni 2

Misioni i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është mbështetja dhe dhënia e kontributit në misionin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Abyei (UNISFA).

Neni 3

Ushtarakët, të cilët marrin pjesë në misionin e Kombeve të Bashkuara në Abyei (UNISFA), për ditët e qëndrimit në këtë mision përfitojnë:

- a) pagën mujore;
- b) dietën ditore për vështirësi shërbimi, në masën që do të caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 370, datë 21.6.2023

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE, PËR NJËSINË VENDORE TË
KUJDESIT SHËNDETËSOR DURRËS, TË
PASURIVE NR. 2/235, 2/238, 2/371 DHE
4/131, ZONA KADASTRALE 8514, DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Durrës, të pasurive nr. 2/235, 2/238, 2/371 dhe 4/131, zona kadastrale 8514, Durrës, sipas formularit dhe planrilevimeve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pasurive, të përcaktuara në pikën, 1 të këtij vendimi, t’i tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE																																								
PRONARI: SHTET		DATE _15.06.2022		QELIMI _____																																				
VENDNDODHJA		DVASHK/ZVASHK _____		ZONA KADASTRALE _8514																																				
BASHKIA_DURRES		NUMRI PASURISE _2/238		INDEX HARTE_DR-K-5																																				
TE DHENAT E PASURISE																																								
LLOJI PASURISE TRUALL		SIP.PASURISE= 151 m2		SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT= _____ m2																																				
		NUMRI KATEVE _____		NUMRI PEMEVE _____																																				
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE																																								
453814.483, 4575678.238				453906.130, 4575680.857																																				
SH 1: 500																																								
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th colspan="2" style="text-align: center;">SHPJEGUES</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td colspan="2">PER NDARJE PASURIE:</td> </tr> <tr> <td>Parcela = _____ m2</td> <td>vijon Parcela 1= _____ m2</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Parcela 2= _____ m2</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Parcela ...= _____ m2</td> </tr> <tr> <td colspan="2">PER BASHKIM PASURIE:</td> </tr> <tr> <td>Parcela 1= _____ m2</td> <td>vijon Parcela= _____ m2</td> </tr> <tr> <td>Parcela 2= _____ m2</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Parcela ...= _____ m2</td> <td></td> </tr> <tr> <td colspan="2">KUFIRI SIPAS HARTES KADASTRALE ■</td> </tr> <tr> <td colspan="2">SIPERFAQE = _____ m2</td> </tr> <tr> <td colspan="2">KUFIRI SIPAS GJENDJES FAKTIKE ■</td> </tr> <tr> <td colspan="2">SIPERFAQE = _____ m2</td> </tr> </tbody> </table>						SHPJEGUES		PER NDARJE PASURIE:		Parcela = _____ m2	vijon Parcela 1= _____ m2		Parcela 2= _____ m2		Parcela ...= _____ m2	PER BASHKIM PASURIE:		Parcela 1= _____ m2	vijon Parcela= _____ m2	Parcela 2= _____ m2		Parcela ...= _____ m2		KUFIRI SIPAS HARTES KADASTRALE ■		SIPERFAQE = _____ m2		KUFIRI SIPAS GJENDJES FAKTIKE ■		SIPERFAQE = _____ m2										
SHPJEGUES																																								
PER NDARJE PASURIE:																																								
Parcela = _____ m2	vijon Parcela 1= _____ m2																																							
	Parcela 2= _____ m2																																							
	Parcela ...= _____ m2																																							
PER BASHKIM PASURIE:																																								
Parcela 1= _____ m2	vijon Parcela= _____ m2																																							
Parcela 2= _____ m2																																								
Parcela ...= _____ m2																																								
KUFIRI SIPAS HARTES KADASTRALE ■																																								
SIPERFAQE = _____ m2																																								
KUFIRI SIPAS GJENDJES FAKTIKE ■																																								
SIPERFAQE = _____ m2																																								
453809.489, 4575611.961				453909.282, 4575611.676																																				
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>ORIENTIMI</th> <th>PERDORIMI</th> <th>TIPI KUFIRIT</th> <th>KUFITARI</th> <th>ID/NIPT</th> <th>SHENIME TE REALIZUESIT</th> </tr> </thead> <tbody> <tr><td>1</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>2</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>3</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>4</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> </tbody> </table>						Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	1							2							3							4						
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT																																		
1																																								
2																																								
3																																								
4																																								
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI: _____ LICENCA: NR. _____ DATE _____ KOMPANIA: _____ NIPT: _____ NENSHKRIMI/VULA _____			TEKNOLOGJIA E MATJEVE: _____ Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: _____ Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: _____																																					
REALIZOI PER ASHK SPECIALISTI DVASHK _____ NENSHKRIMI _____			PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI _____ NENSHKRIMI _____																																					
KONFIRMOI Ergert PERGJEGJESI/DREJTOR Delialisi NENSHKRIMI / VULA _____			Digitally signed by Ergert Delialisi Date: 2022.07.05 08:16:11 +0200																																					
Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																																								



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE																																								
PRONARI: SHTET		DATE 15.06.2022		QELLIMI																																				
/ENDNDODHJA																																								
BASHKIA_DURRES	DVASHK/ZVASHK	ZONA KADASTRALE_8514	NUMRI PASURISE_2/371	INDEX HARTE_DR-K-5																																				
TE DHENAT E PASURISE																																								
LLOJI PASURISE TRUALL	SIP.PASURISE= 113.5 m2	SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT=	NUMRI KATEVE	NUMRI PEMEVE																																				
453814.483, 4575678.238		KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE		453906.130, 4575680.857																																				
453809.489, 4575611.961		SH 1: 500		453909.282, 4575611.676																																				
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>ORIENTIMI</th> <th>PERDORIMI</th> <th>TIPI KUFIRIT</th> <th>KUFITARI</th> <th>ID/NIPT</th> <th>SHENIME TE REALIZUESIT</th> </tr> </thead> <tbody> <tr><td>1</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>2</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>3</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>4</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> </tbody> </table>						Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	1							2							3							4						
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT																																		
1																																								
2																																								
3																																								
4																																								
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI: _____ LICENCA: NR. _____ DATE _____ KOMPANIA: _____ NIPT: _____ NENSHKRIMI/VULA _____ REALIZOI PER ASHK SPECIALISTI _____ DVASHK _____ NENSHKRIMI _____ KONFIRMOI Ergert PERGJEGJESI/DREJTOR Detalishi NENSHKRIMI / VULA _____			TEKNOLOGJIA E MATJEVE: _____ Kode per teknologji e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: _____ Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: _____ PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI _____ NENSHKRIMI _____																																					
Kode per teknologji e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																																								



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE																																								
PRONARI SHETET		DATE 22.12.2022		QELIMI																																				
ENDNDODHJA																																								
ASHKIA_DURRES	DVASHK/ZVASHK	ZONA KADASTRALE_8514	NUMRI PASURISE_4/131	INDEX HARTE_DR-HI-4,5																																				
E DHENAT E PASURISE																																								
LOJI PASURISE ND + TRUALL SIP.PASURISE= 950 m2 SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT= 500.1 m2 NUMRI KATEVE 2KT dhe 1KT NUMRI PEMEVE																																								
53912.998, 4575581.238		KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE		454009.178, 4575578.018																																				
SH 1: 500																																								
SHPJEGUES KUFIRI SIPAS HARTES KADASTRALE ■ SIPERFAQE = 950 m2 KUFIRI SIPAS GJENDJES FAKTIKE ■ SIPERFAQE = 952 m2																																								
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="width: 5%;">Nr.</th> <th style="width: 15%;">ORIENTIMI</th> <th style="width: 15%;">PERDORIMI</th> <th style="width: 15%;">TIPI KUFIRIT</th> <th style="width: 15%;">KUFITARI</th> <th style="width: 15%;">ID/NIPT</th> <th style="width: 20%;">SHENIME TE REALIZUESIT</th> </tr> </thead> <tbody> <tr><td>1</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>2</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>3</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>4</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> </tbody> </table>						Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	1							2							3							4						
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT																																		
1																																								
2																																								
3																																								
4																																								
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT MRI: _____ ICENCA: NR. _____ COMPANIA: _____ IPT: _____ ENSHKRIMI/VULA _____			TEKNOLOGJIA E MATJEVE: _____ Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: _____ Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: Objekti = 328 m2 2 KT Magazina 1 = 115.2 m2 1 KT Magazina 2 = 12.1 m2 1 KT Garazh 1 = 22.4 m2 1 KT Garazh 2 = 22.4 m2 1 KT TOTALI = 500.1 m2																																					
REALIZOI PER ASHK PECIALISTI _____ VASHK _____ ENSHKRIMI _____ Enli ONFIRMOI _____ ERGJEGJESI/DREJTOR _____ Kaculi ENSHKRIMI / VULA _____			PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI _____ ENSHKRIMI _____																																					
ode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i ronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																																								



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE																																								
PRONARI SHTET		DATE 10.03.2023		QELIMI _____																																				
VENDNDODHJA BASHKIA_DURRES DVASHK/ZVASHK ZONA KADASTRALE_8514 NUMRI PASURISE 2/235 INDEX HARTE_DR-I-5																																								
TE DHENAT E PASURISE LLONI PASURISE TRUALL SIP.PASURISE= 416 m2 SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT= _____m2 NUMRI KATEVE _____ NUMRI PEMEVE _____																																								
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE																																								
453814.483, 4575678.238 453906.130, 4575680.857 453809.489, 4575611.961 SH 1: 500 453909.282, 4575611.676																																								
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>ORIENTIMI</th> <th>PERDORIMI</th> <th>TIPI KUFRIT</th> <th>KUFRITARI</th> <th>ID/NIPT</th> <th>SHENIME TE REALIZUESIT</th> </tr> </thead> <tbody> <tr><td>1</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>2</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>3</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>4</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> </tbody> </table>						Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFRIT	KUFRITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	1							2							3							4						
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFRIT	KUFRITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT																																		
1																																								
2																																								
3																																								
4																																								
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI: _____ LICENCA: NR. _____ DATE _____ KOMPANIA: _____ NIPT: _____ NENSHKRIMI/VULA _____			TEKNOLOGJIA E MATJEVE: _____ Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFRIT: _____ Kode per percaktimin e kufririt: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: _____																																					
REALIZOI PER ASHK SPECIALISTI _____ DVASHK _____ NENSHKRIMI _____			PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFRARET EMRI _____ NENSHKRIMI _____																																					
KONFRMOI Enli PERGJEGJESI/DREKTOR _____ NENSHKRIMI / VULA _____			Digitally signed by Enli Kaculi Date: 2023.03.10 10:42:59 +0200																																					
Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufririt: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																																								



I-FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHITËTËRORE

(Për inventarizimin e pronave të vecanta)

Institucioni Pushtetit Qendror Ministria e Shëndetësisë											
Identifikimi: Ing. Enli Kaculi											
Supervizori:											
Fusha e përdorimit të pronës: Shëndetësi NivKSH Durrës											
C											
B											
A											
Nr	Zona Kadastrale dhe indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës adresë	Sipërfaqja totale e pronës (sheshi+objekti) (m ²)	Sipërfaqja vetem e objektit (m ²)	Nr. i kateve shoqruar me sipërfaqe cdo kati (m ²)	Institucioni për dorëzuesin. Statusi juridik i përdorimit	Institucioni me përgjegjësi administrative	SHENIMET E VECANTA	
1		2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	DR J-5	2/235	Tuall	Ish godina e NIVKSH + Q.SH nr 1 dhe Klinika stomatologjike Lagia 4 Rruga FETAH BILACA	416 m ²				NIVKSH dhe Q.SH nr 1	M.S.H.M.S	Objekti është prishur me vendim të M.S.H.M.S shkresa nr .182/24 prot dt 17.06.2020 dhe me urdher të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Nr. 62 dt 29.06.2020 me Nr.1599 Prot dt 29.06.2020
2	DR J-5	2/238	Tuall		151 m ²				NIVKSH dhe Q.SH nr 1	M.S.H.M.S	Truall
3	DR J-5	2/371	Tuall		113,5 m ²				NIVKSH dhe Q.SH nr 1	M.S.H.M.S	Truall
2	Dr- 8514 DR L-5	4/131	Ndertim + Truall	Sherbim i Higjenes dhe Epidermiologjisë	950 m ²	500.1 m ²	2 kate ndertim per dhe sip. 328 m ²	kati i pare sip.340,5 m ²	NIVKSH	M.S.H.M.S	
1	DR L-5		Ndertim + Truall	Objekt 2 K		328 m ²	me 328 m ²		NIVKSH	M.S.H.M.S	
2	DR L-5		Ndertim + Truall	Magazine 1 kat		115,2 m ²	1 kat siperf. 115,2 m ²		NIVKSH	M.S.H.M.S	
3	DR L-5		Ndertim + Truall	Magazine 1 kat		12,1 m ²	1 kat siperf. 12,1 m ²		NIVKSH	M.S.H.M.S	
4	DR L-5		Ndertim + Truall	Garazh 1 kat		22,4 m ²	1 kat siperf. 22,4 m ²		NIVKSH	M.S.H.M.S	
5	DR L-5		Ndertim + Truall	Garazh 1 kat		22,4 m ²	1 kat siperf. 22,4 m ²		NIVKSH	M.S.H.M.S	

**VENDIM****Nr. 371, datë 21.6.2023****PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 270, DATË 2.5.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PJESËMARRJEN E PERSONELIT TË
FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
MISIONIN E KOMBEVE TË
BASHKUARA NË SUDANIN E JUGUT
(UNMISS)”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 2 e 5, të nenit 6, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të aktit normativ nr. 1, datë 20.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS)”, miratuar me ligjin nr. 23/2019, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 270, datë 2.5.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 1, data “15.3.2023” ndryshohet dhe bëhet “15.3.2024”;

b) Në pikën 3 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i. Në shkronjën “a”, togfjalëshi “... 8 000 (tetë mijë) ...” zëvendësohet me “... 12 000 (dymbëdhjetë mijë) ...”;

ii. Pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) çdo shpenzim tjetër për mbarrëvajtjen e kryerjes së operacionit.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Belinda Balluku****VENDIM****Nr. 372, datë 21.6.2023****PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN
NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E
SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË
KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN,
PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE
SHFUQIZIMIN E MASAVE
SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE,
TË NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 32, të kreut I, shtohet pika 33, me këtë përmbajtje:

“33. Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2023/891, në lidhje me masat kufizuese në funksion të veprimeve që destabilizojnë Republikën e Moldavisë, sipas aneksit 33, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

2. Pas aneksit 32, bashkëlidhur vendimit, shtohet aneksi 33, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Belinda Balluku**



ANEKSI 33

VENDIME

VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2023/891

i datës 28 prill 2023

lidhur me masat kufizuese në funksion të veprimeve që destabilizojnë Republikën e Moldavisë

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke patur parasysh që:

- (1) Më 23 qershor 2022, Këshilli Evropian i dha statusin e vendit kandidat Republikës së Moldavisë.
- (2) Në konkluzionet e tij të 23 marsit 2023, Këshilli Evropian u zotua të vazhdojë të ofrojë të gjithë mbështetjen përkatëse për Republikën e Moldavisë, duke përfshirë forcimin e qëndrueshmërisë, sigurisë, stabilitetit, ekonomisë dhe furnizimit me energji të vendit përballë aktiviteteve destabilizuese nga aktorët e jashtëm.
- (3) Udhëheqja aktuale e Republikës së Moldavisë ka bërë përparim të rëndësishëm në forcimin e demokracisë dhe sundimit të ligjit, si dhe në luftën kundër korrupsionit, dhe ka bërë përpjekje të konsiderueshme në zbatimin e hapave të specifikuar në Opinionin e Komisionit Evropian për aplikimin e saj për anëtarësim në BE.
- (4) Ndërsa vazhdon agjendën e saj ambicioze të reformave, qeveria moldave është përballur gjithashtu me kriza të shumta dhe është përballur gjithnjë e më shumë me kërcënime të drejtpërdrejta ndaj stabilitetit të saj që vijnë qoftë si nga grupet e brendshme me interesa personale, ashtu edhe nga Rusia, të cilat shpesh bashkëpunojnë për të devijuar vendin nga rruga e tij reformuese.
- (5) Unioni mbetet i gatshëm të përdorë të gjitha instrumentet e politikës në dispozicion për të kontribuar në një mënyrë efektive për të dalë nga kriza aktuale dhe për të reaguar ndaj veprimeve destabilizuese që përbëjnë një kërcënim serioz për demokracinë dhe sundimin e ligjit në Republikën e Moldavisë, gjithashtu duke forcuar zbatimin e asistencës teknike dhe programeve të ngritjes së kapaciteteve për të rritur aftësinë e Republikës së Moldavisë për të parandaluar dhe luftuar në mënyrë autonome veprime të tilla nëpërmjet bashkëpunimit gjyqësor dhe policor me shtetet anëtare.
- (6) Intensiteti i lartë i paparë i veprimeve të tilla destabilizuese kërkon reagim të menjëhershëm, duke pasur parasysh gjithashtu rëndësinë e një Republike të qëndrueshme të Moldavisë, një vend kandidat për në BE në kufi me Unionin dhe Ukrainën.
- (7) Një kërcënim për demokracinë dhe shtetin e së drejtës, si dhe për stabilitetin dhe sigurinë e Republikës së Moldavisë, paraqesin persona që pengojnë ose minojnë mbajtjen e zgjedhjeve ose tentojnë të përmbysin rendin kushtetues, duke përfshirë akte dhune, në Republikën e Moldavisë. Përpjekjet për të destabilizuar Republikën e Moldavisë u rritën veçanërisht që nga fillimi i luftës së agresionit rus kundër Ukrainës.
- (8) Kërcënim për stabilitetin, demokracinë dhe shtetin e së drejtës paraqesin edhe personat që përfshihen në sjellje të pahijshme financiare në lidhje me fondet publike dhe eksportin e paautorizuar të kapitalit, për aq sa ata mund të marrin kontrollin ose të ndikojnë seriozisht në aktivitetet e autoriteteve shtetërore. Veprime të tilla mund të kërcënojnë edhe rendin kushtetues.
- (9) Përpjekjet destabilizuese kundër Republikës së Moldavisë kërcënojnë stabilitetin dhe sigurinë e kufijve të jashtëm të Unionit.
- (10) Republika e Moldavisë ka kërkuar mbështetjen e Unionit kundër veprimeve që kërcënojnë të destabilizojnë vendin



duke miratuar masa kufizuese.

(11) Në rrethanat aktuale, kufizimet e udhëtimit dhe masat e ngjirjes së aseteve duhet të vendosen kundër personave përgjegjës për mbështetjen ose zbatimin e veprimeve ose politikave, që minojnë ose kërcënojnë sovranitetin dhe pavarësinë e Republikës së Moldavisë, dhe demokracinë, sundimin e ligjit, stabilitetin ose sigurinë në Republikën e Moldavisë, dhe personat, subjektet ose organet e lidhura me to.

(12) Veprime të mëtejshme nga Unioni nevojiten për të zbatuar masa të caktuara,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

1. Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për të parandaluar hyrjen ose kalimin tranzit nëpër territoret e tyre të:
 - (a) personat fizikë përgjegjës, që mbështesin ose zbatojnë veprime ose politika që minojnë ose kërcënojnë sovranitetin dhe pavarësinë e Republikës së Moldavisë, ose demokracinë, sundimin e ligjit, stabilitetin ose sigurinë në Republikën e Moldavisë nëpërmjet një prej veprimeve të mëposhtme:
 - (i) pengimi ose minimi i procesit politik demokratik, duke përfshirë pengimin ose minimin serioz të mbajtjes së zgjedhjeve ose përpjekjen për të destabilizuar ose përmbysur rendin kushtetues;
 - (ii) planifikimin, drejtimin, përfshirjen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, mbështetjen ose lehtësimin e demonstratave të dhunshme ose akteve të tjera të dhunës; ose
 - (iii) shkelje serioze financiare në lidhje me fondet publike dhe eksportin e paautorizuar të kapitalit;
 - (b) personat fizikë të lidhur me personat e përcaktuar në pikën (a);
siç renditet në Aneks.
2. Paragrafi 1 nuk e detyron një Shtet Anëtar që të refuzojë shtetasit e tij për hyrje në territorin e tij.
3. Paragrafi 1 nuk paragjykon rastet kur një Shtet Anëtar është i detyruar nga një detyrim i së drejtës ndërkombëtare, përkatësisht:
 - (a) si vend pritës i një organizate ndërkombëtare ndërqeveritare;
 - (b) si një vend pritës i një konference ndërkombëtare të thirrur nga ose nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara;
 - (c) sipas një marrëveshjeje shumëpalëshe që jep privilegje dhe imunitete; ose
 - (d) sipas Traktatit të Pajtitimit të vitit 1929 (pakti Lateran) i lidhur nga Selia e Shenjtë (Shteti i Qytetit të Vatikanit) dhe Italia.
4. Paragrafi 3 do të zbatohet gjithashtu në rastet kur një Shtet Anëtar është vendi pritës i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).
5. Këshilli do të informohet siç duhet në të gjitha rastet kur një Shtet Anëtar jep një përjashtim në përputhje me paragrafët 3 ose 4.
6. Shtetet Anëtare mund të japin përjashtime nga masat e vendosura sipas paragrafit 1, kur udhëtimi justifikohet për arsye të nevojës urgjente humanitare ose për shkak të pjesëmarrjes në takime ose takime ndërqeveritare të promovuara ose të organizuara nga Unioni, ose të organizuara nga një shtet anëtar që mban kryesimin në zyrën e OSBE-së, ku zhvillohet një dialog politik që promovon drejtpërdrejt objektivat e politikave të masave kufizuese, duke përfshirë mbështetjen për sundimin e ligjit, demokracinë, stabilitetin dhe sigurinë e Republikës së Moldavisë.



7. Shtetet Anëtare mund të bëjnë gjithashtu përjashtime nga masat e vendosura sipas paragrafit 1 kur hyrja ose tranziti është i nevojshëm për përmbushjen e një procesi gjyqësor

8. Një Shtet Anëtar që dëshiron të bëjë përjashtime të përmendura në paragrafin 6 ose 7 duhet të njoftojë Këshillin me shkrim. Përjashtimi do të konsiderohet i dhënë nëse një ose më shumë Shtete Anëtare nuk ngrenë një kundërshtim me shkrim brenda dy ditëve pune nga marrja e njoftimit për përjashtimin e propozuar. Nëse një ose më shumë Shtete Anëtare ngrenë një kundërshtim, Këshilli, duke vepruar me shumicë të cilësuar, mund të vendosë të japë përjashtimin e propozuar.

9. Kur, në përputhje me paragrafët 3, 4, 6, 7 dhe 8, një Shtet Anëtar autorizon hyrjen ose kalimin transit përmes territorit të tij të personave të listuar në Aneks, autorizimi do të kufizohet në qëllimin për të cilin është dhënë ndaj personit në fjalë.

Neni 2

1. Të gjitha fondet dhe burimet ekonomike që i përkasin, zotërohen, mbahen ose kontrollohen nga:

- (a) personat fizikë, subjektet ose organet përgjegjëse që mbështesin ose zbatojnë veprime ose politika që minojnë ose kërcënojnë sovranitetin dhe pavarësinë e Republikës së Moldavisë, ose demokracinë, sundimin e ligjit, stabilitetin ose sigurinë në Republikën e Moldavisë nëpërmjet një prej veprimeve të mëposhtme :
- (i) pengimi ose minimi i procesit politik demokratik, duke përfshirë pengimin ose minimin serioz të mbajtjes së zgjedhjeve ose përpjekjen për të destabilizuar ose përmbysur rendin kushtetues;
 - (ii) planifikimin, drejtimin, përfshirjen në, drejtpërdrejt ose tërthorazi, mbështetjen ose lehtësimin e demonstratave të dhunshme ose akteve të tjera të dhunës; ose
 - (iii) shkelje serioze financiare në lidhje me fondet publike dhe eksportin e paautorizuar të kapitalit;
- (b) personat fizikë ose juridikë, subjektet ose organet e lidhura me personat e përcaktuar në pikën (a);
- siç renditet në Aneks, do të ngrihet.

2. Asnjë fond ose burim ekonomik nuk do të vihet në dispozicion, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për ose në dobi të personave fizikë ose juridikë, subjekteve ose organeve të listuara në Aneks.

3. Duke përjashtuar paragrafët 1 dhe 2, autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare mund të autorizojnë lirimin e disa fondeve ose burimeve ekonomike të ngrira, ose vënien në dispozicion të fondeve ose burimeve ekonomike të caktuara, në kushte të tilla që ata i konsiderojnë të përshtatshme, pasi të jetë përcaktuar se fondet ose burimet ekonomike në fjalë janë:

- a) të nevojshme për të plotësuar nevojat bazë të personave të listuar në Aneks dhe anëtarëve të familjes së tyre në ngarkim, duke përfshirë pagesat për ushqime, qira ose hipotekë, ilaçe dhe trajtim mjekësor, taksa, prime sigurimi dhe tarifa të shërbimeve publike;
- b) të destinuara ekskluzivisht për pagesën e tarifave të arsyeshme profesionale dhe rimbursimin e shpenzimeve të bëra që lidhen me ofrimin e shërbimeve ligjore;
- c) të destinuara ekskluzivisht për pagesën e shpenzimeve ose të tarifave të shërbimit për mbajtjen ose mirëmbajtjen rutinë të fondeve ose burimeve ekonomike të ngrira;
- d) të nevojshme për shpenzime të jashtëzakonshme, me kusht që autoriteti kompetent të ketë njoftuar autoritetet kompetente të Shteteve të tjera Anëtare dhe Komisionin për arsytet mbi të cilat ai konsideron se duhet të jepet një autorizim specifik, të paktën dy javë përpara autorizimit; ose
- e) të paguhet në ose nga një llogari e një misioni diplomatik ose posti konsullor ose një organizatë ndërkombëtare që gëzon imunitete në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, për aq sa këto pagesa synohen të përdoren për qëllime zyrtare të misionit diplomatik ose postit konsullor ose organizatës ndërkombëtare.

Shteti Anëtar në fjalë informon Shtetet e tjera Anëtare dhe Komisionin për çdo autorizim të dhënë sipas këtij paragrafi.



4. Me përjashtim të paragrafit 1, autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare mund të autorizojnë lirimin e disa fondeve të ngrira ose burimeve ekonomike, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- (a) fondet ose burimet ekonomike janë objekt i një vendimi arbitrazhi të marrë përpara datës në të cilën personi, entiteti ose organi i përmendur në paragrafin 1 është renditur në aneks, ose i një vendimi gjyqësor ose administrativ të marrë në Union, ose një vendim gjyqësor i zbatueshëm në shtetin anëtar në fjalë, para ose pas kësaj date;
- (b) fondet ose burimet ekonomike do të përdoren ekskluzivisht për të përmbushur kërkesat e siguruar nga një vendim i tillë ose të njohura si të vlefshme në një vendim të tillë, brenda kufijve të përcaktuar nga ligjet dhe rregulloret në fuqi që rregullojnë të drejtat e personave që kanë pretendime të tilla;
- (c) vendimi nuk është në dobi të një personi fizik ose juridik, subjekti ose organi të listuar në Aneks; dhe
- (d) njohja e vendimit nuk është në kundërshtim me politikën publike në shtetin anëtar në fjalë.

Shteti Anëtar në fjalë do të informojë Shtetet e tjera Anëtare dhe Komisionin për çdo autorizim të dhënë sipas këtij paragrafi brenda dy javësh nga autorizimi.

5. Paragrafi 1 nuk e pengon një person, ent ose organ fizik ose juridik të listuar që të bëjë një pagesë sipas një kontrate të lidhur përpara datës në të cilën ky person fizik ose juridik, entitet ose organ është renditur në Aneks, me kusht që Shteti Anëtar në fjalë të ketë përcaktuar se pagesa nuk është marrë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga një person fizik ose juridik, subjekt ose organ i përmendur në paragrafin 1.

6. Paragrafi 2 nuk zbatohet për shtimin në llogaritë e ngrira të:

- (a) interesit ose fitimeve të tjera në këto llogari;
- (b) pagesave që paguhën sipas kontratave, marrëveshjeve ose detyrimeve që janë lidhur ose kanë lindur përpara datës në të cilën këto llogari janë bërë objekt i masave të parashikuara në paragrafët 1 dhe 2; ose
- (c) pagesave të detyrueshme sipas vendimeve gjyqësore, administrative ose arbitrazhi të dhëna në Unioni ose të zbatueshme në Shtetin Anëtar në fjalë,

me kusht që çdo interes i tillë, fitime dhe pagesa të tjera të mbeten subjekt i masave të parashikuara në paragrafin 1.

7. Ndalimi i përcaktuar në paragrafin 2 nuk do të zbatohet për organizatat dhe agjencitë të cilat janë vlerësuar si shtylla nga Unioni dhe me të cilat Unioni ka nënshkruar një marrëveshje partneriteti kornizë financiare në bazë të së cilës organizatat dhe agjencitë veprojnë si partnerë humanitarë të Unionit, me kusht që sigurimi i fondeve ose burimeve ekonomike të përmendura në paragrafin 2 të jetë i nevojshëm për qëllime ekskluzivisht humanitare në Republikën e Moldavisë.

8. Në rastet që nuk mbulohen nga paragrafi 7, dhe duke përjashtuar paragrafët 1 dhe 2, autoritetet kompetente të një Shteti Anëtar mund të japin autorizime specifike ose të përgjithshme, në kushte të tilla të përgjithshme ose specifike që ata e gjykojnë të përshtatshme, për të liruar disa fonde të ngrira ose burime ekonomike ose për të vënë në dispozicion fonde ose burime të caktuara ekonomike, me kusht që sigurimi i këtyre fondeve ose burimeve ekonomike të jetë i nevojshëm për qëllime ekskluzivisht humanitare në Republikën e Moldavisë.

Neni 3

1. Këshilli, duke vepruar me unanimitet me propozimin e një Shteti Anëtar ose nga Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë ("Përfaqësuesi i Lartë"), vendos të krijojë dhe të ndryshojë listën në aneks.

2. Këshilli do t'ia komunikojë vendimin e përmendur në paragrafin 1, duke përfshirë arsyet e listimit, personit fizik ose juridik, subjektit ose organit të interesuar, qoftë drejtpërdrejt, nëse adresa dihet, qoftë nëpërmjet publikimit të një njoftimi, duke i ofruar një personi, entiteti ose organi të tillë një mundësi për të paraqitur vërejtje.

3. Kur paraqiten vërejtje, ose kur paraqiten prova të reja thelbësore, Këshilli do të shqyrtojë vendimin e përmendur në paragrafin 1 dhe do të informojë personin, entitetin ose organin në fjalë në përputhje me rrethanat.



Neni 4

1. Shtojca do të përfshijë arsyet për renditjen e personave, subjekteve dhe organeve fizike dhe juridike të përmendura në nenet 1 dhe 2.
2. Shtojca do të përmbajë, kur është i disponueshëm, informacionin e nevojshëm për të identifikuar personat, subjektet ose organet fizike ose juridike të interesuara. Në lidhje me personat fizikë, këto informacione mund të përfshijnë: emrat dhe pseudonimet; datën dhe vendin e lindjes; kombësinë; numrat e pasaportës dhe kartës së identitetit; gjininë; adresën, nëse dihet; dhe funksionin apo profesionin. Në lidhje me personat juridikë, subjektet ose organet, informacioni i tillë mund të përfshijë: emrat; vendin dhe datën e regjistrimit; numrin e regjistrimit; dhe vendin e biznesit.

Neni 5

1. Këshilli dhe Përfaqësuesi i Lartë mund të përpunojnë të dhëna personale për të kryer detyrat e tyre sipas këtij vendimi, në veçanti:
 - (a) për sa i përket Këshillit, për përgatitjen dhe bërjen e ndryshimeve në Aneks;
 - (b) në lidhje me Përfaqësuesin e Lartë, për përgatitjen e amendamenteve të Aneksit.
2. Këshilli dhe Përfaqësuesi i Lartë mund të përpunojnë, sipas rastit, të dhëna përkatëse në lidhje me veprat penale të kryera nga personat fizikë të listuar, me dënimet penale ose me masat e sigurisë në lidhje me këta persona, vetëm në masën që ky përpunim është i nevojshëm për përgatitjen e aneksit.
3. Për qëllimet e këtij vendimi, Këshilli dhe Përfaqësuesi i Lartë caktohen si 'kontrollues' sipas kuptimit të pikës (8) të nenit 3 të Rregullores (BE) 2018/1725 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ⁽¹⁾, për të siguruar që personat fizikë në fjalë mund të ushtrojnë të drejtat e tyre sipas Rregullores (BE) 2018/1725.

Neni 6

Asnjë pretendim në lidhje me ndonjë kontratë ose transaksion, kryerja e të cilave është prekur, drejtpërdrejt ose tërthorazi, tërësisht ose pjesërisht, nga masat e vendosura sipas këtij vendimi, duke përfshirë pretendimet për dëmshpërblim ose ndonjë pretendim tjetër të këtij lloji, si p.sh. kërkesa për kompensim ose një kërkesë për një garanci, veçanërisht një kërkesë për zgjatjen ose pagesën e një obligacioni, garancie ose dëmshpërblimi, në veçanti një garanci financiare ose dëmshpërblim financiar, të çfarëdo forme, nuk do të përmbushet, nëse ato bëhen nga:

- (a) personat, subjektet ose organet fizike ose juridike të përcaktuara të listuara në Aneks;
- (b) çdo person fizik ose juridik, subjekt ose organ që vepron nëpërmjet ose në emër të një prej personave, subjekteve ose organeve të përmendura në pikën (a).

Neni 7

Për të maksimizuar ndikimin e masave të përcaktuara në këtë Vendim, Unioni inkurajon shtetet e treta të miratojnë masa kufizuese të ngjashme me ato të parashikuara në këtë Vendim.

Neni 8

Ky Vendim do të zbatohet deri më 29 prill 2024.

Ky Vendim do të mbahet në shqyrtim të vazhdueshëm. Ai do të rinovohet, ose do të ndryshohet sipas rastit, nëse Këshilli gjykon se objektivat e tij nuk janë përmbushur.

⁽¹⁾ Rregullorja (BE) 2018/1725 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 tetor 2018 për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Unionit dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimi i Rregullores (KE) Nr. 45/2001 dhe Vendimit Nr. 1247/2002/EC (OJ L 295, 21.11.2018, f. 39).



Në shqyrtimin e masave kufizuese të marra në përputhje me nenin 1(1)(a)(iii) dhe 2(1)(a)(iii), Këshilli do të marrë parasysh sipas rastit nëse personat në fjalë ju nënshtrohen procedurave gjyqësore apo jo në lidhje me sjelljen për të cilën janë renditur.

Neni 9

Ky Vendim hyn në fuqi një ditë pas publikimit të tij në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bërë në Bruksel, më 28 prill 2023.

Për Këshillin
Presidenti
J. ROSWALL



ANNEX

List of natural and legal persons, entities and bodies referred to in Articles 1 and 2

[...]



DECISIONS

COUNCIL DECISION (CFSP) 2023/891

of 28 April 2023

concerning restrictive measures in view of actions destabilising the Republic of Moldova

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Whereas:

- (1) On 23 June 2022, the European Council granted the status of candidate country to the Republic of Moldova.
- (2) In its conclusions of 23 March 2023, the European Council pledged to continue to provide all relevant support to the Republic of Moldova, including to strengthen the country's resilience, security, stability, economy and energy supply in the face of destabilising activities by external actors.
OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 880, datë 23.4.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2022-1130, datë 13.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, pika 2, 18, pika 1, 33, pika 1, 41, pikat 1 dhe 2, 42, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); neni 27 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuases, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 22.11.1992, me urdhër të kryetarit të këshillit të rrethit Elbasan kërkesja është emëruar në detyrën e “specialistes” së privatizimit dhe në zbatim të urdhrit të datës 30.7.1997 ka vijuar marrëdhënien e punës në varësi të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, në detyrën e “specialistes” në degën e shoqërive publike Elbasan.

2. Me shkresën nr. 786 prot., datë 31.10.2013, kërkesja është njoftuar për fillimin e procedurës së zgjidhjes së marrëdhënieve të saj të punës me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe

Sipërmarrjes (MZHETS), për shkak të shkurtimit të vendit të punës, si rrjedhojë e ristrukturimit të institucionit, sipas urdhrit nr. 181, datë 18.10.2013 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”. Në vijim, me urdhrin nr. 85, datë 15.11.2013 të ministrit është vendosur lirimi i saj nga detyra.

3. Kërkesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës me kërkesëpadi me objekt: “1. Kthim në vendin e mëparshëm të punës në pozicionin e specialistes në Degën e Shoqërive Publike Elbasan, si pasojë e pavlefshmërisë absolute të urdhrit nr. 85, datë 15.11.2013, “Për lirim nga detyra” të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. 2. Pagimin e pagës për të gjithë kohën e qëndrimit pa punë padrejtësisht deri në ekzekutimin e vendimit të gjykatës. 3. Pezullimi i zbatimit të këtij urdhri deri në përfundim të procedurave të rekrutimit në Degën e Shoqërive Publike Elbasan deri në përfundim të procesit gjyqësor”, për të cilën gjykata, me vendimin nr. 601, datë 12.5.2014, të dhënë në prani të përfaqësuesit të kërkuases dhe përfaqësuesit të MZHETS-së (shih procesverbalin nr. 651, datë 12.5.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës), ka vendosur pranimin pjesërisht të saj, rikthimin e kërkuases në pozicionin e saj të punës, detyrimin e MZHETS-së t’i paguajë pagën dhe përfitimet e tjera nga momenti i shkëputjes së marrëdhënieve financiare deri në momentin e rikthimit në detyrë, si dhe rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të objektit të saj.

4. MZHETS-ja, përmes aktit nr. 2624/3 prot., datë 26.5.2014, ka ushtruar ankim kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ky ankim është dërguar me postë jo në adresë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, por asaj Tiranë. Ky akt procedural ka mbetur pa veprim deri kur kancelarja e kësaj të fundit e ka përcjellë atë me postë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës me shkresën nr. 10720 prot., datë 4.9.2014, duke informuar se ankimi është depozituar në këtë gjykatë në datën 28.5.2014.

5. Në kushtet kur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës nuk ka rezultuar i depozituar ankim brenda afatit ligjor 15-ditor nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit, kërkesja është pajisur me kopje të tij me shënimin se ai ka marrë formë të prerë në datën 27.5.2014. Në vijim ajo i është drejtuar shërbimit përmbartimor gjyqësor privat për vënien e tij në ekzekutim. Ky i fundit ka



njoftuar MZHETS-në në datën 12.8.2014 për ekzekutimin vullnetar dhe me kalimin e afatit, në kushtet e mospërbushjes së detyrimit, ka vendosur fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, duke urdhëruar Degën e Thesarit Durrës për vendosjen e sekuestros në llogarinë e MZHETS-së.

6. Me marrjen dijeni për masën e sekuestros, MZHETS-ja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës me kërkesëpadi kundër kërkueses dhe shoqërisë përmbartimore private, me objekt: *“Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 601, datë 12.5.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës. Anulimin e urdhrat për vënien e sekuestros nr. 1296 prot., datë 26.8.2014 të përmbartuesit gjyqësor E.S., si veprim absolutisht i pavlefshëm”*, duke pretenduar, ndër të tjera, se vendimi gjyqësor në fjalë nuk ishte titull ekzekutiv pasi nuk ka marrë formë të prerë, ndërsa kundër tij është depozituar ankimi brenda afatit ligjor.

7. Krahas kërkesëpadisë së mësipërme, në datën 5.9.2014, përmes shërbimit postar, MZHETS-ja ka dërguar në adresë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës ankimin kundër vendimit nr. 601, datë 12.5.2014, sipas aktit nr. 2624/3 prot., datë 26.5.2014, që më herët ishte dërguar në adresë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Në këtë rast ankimi është shoqëruar me fotokopjen e njëzuar me origjinalin të një prej faqeve të librit të dorëzimit të postës. Në këtë të fundit, në shënimet e datës 26.5.2014, pasqyrohet dërgimi i dy shkresave, ndër to edhe ajo nr. 2624/3, në adresë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Mbi shënimet e kësaj date është edhe vula postare që mban datën 26.5.2014. Ankimi është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës në datën 8.9.2014.

8. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, gjyqtari i vetëm i saj, ka verifikuar plotësimin e kushteve të pranueshmërisë për shqyrtim të ankimit të MZHETS-së kundër vendimit nr. 601, datë 12.5.2014 dhe me vendimin e datës 8.9.2014 ka vendosur pranimin e ankimit duke urdhëruar njoftimin e tij kërkueses. Për sa i përket afatit të paraqitjes së ankimit, gjyqtari i vetëm në vendimin e tij ka evidentuar se ai është nisur me postë në datën 26.5.2014 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pas njoftimit të ankimit kërkuësja ka paraqitur kërkesë për kthimin e ankimit bazuar në nenin 450 të Kodit

të Procedurës Civile (KPC), me pretendimin se ai është paraqitur jashtë afatit ligjor 15-ditor. Po ashtu kërkuësja ka paraqitur edhe kundërankim, duke kërkuar lënien në fuqi të vendimit nr. 601, datë 12.5.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

9. Mbi ankimin e MZHETS-së dhe kundërankimin e kërkueses, çështja e themelit është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit në dhomën e këshillimit, ndërkohë që pas njoftimit të bërë për shqyrtimin e çështjes, kërkuësja ka paraqitur një parashtesë me shkrim, duke kërkuar mospranimin e ankimit të MZHETS-së, për shkak të depozitimit të tij jashtë afatit ligjor. Respektimi i afatit të paraqitjes së ankimit dhe pranueshmëria për shqyrtim e tij është bërë objekt shqyrtimi nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka arritur në përfundimin se ankimi është paraqitur konform kërkesave ligjore të neneve 44, 45 dhe 46 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012), brenda afatit ligjor, në respektim të formës dhe përmbajtjes së kërkuar nga neni 454 i KPC-së, përpara gjykatës kompetente, nga subjekti i legjitimuar pasivisht në padi, i legjitimuar edhe në të drejtën e ankimit, jashtë kushteve ndaluese të nenit 45 të ligjit nr. 49/2012. Pretendimi i kërkueses është gjetur i pabazuar nga ajo gjykatë, ndërsa ka pranuar se ankimi i MZHETS-së, për shkaqe që nuk dihen, është depozituar gabimisht nga shërbimi postar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe është përcjellë për veprime ligjore drejt Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës me shkresën nr. 10720 prot., datë 4.9.2014 të kancelares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Po sipas kësaj gjykate, me të drejtë gjyqtari i vetëm i gjykatës së shkallës së parë, për veprime të shërbimit postar dhe sekretarisë gjyqësore që nuk mund të ngarkojnë me përgjegjësi MZHETS-në, ka vendosur pranimin e ankimit, duke e konsideruar të paraqitur brenda afatit ligjor (shih vendimin nr. 880, datë 23.4.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit, faqja 16, pika 8). Në përfundim të gjykimin, pas shqyrtimit të çështjes në themel, me vendimin nr. 880, datë 23.4.2015, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, duke rrëzuar kërkesëpadinë e kërkueses.



10. Kërkuesja ka ushtruar rekurs, për të cilin Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2022-1130, datë 13.5.2022, ka vendosur mospranimin e tij, duke vlerësuar se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, të cilat do ta bënin të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit. Sipas saj, përfundimi i arritur nga gjykata e apelit është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të kërkesave të ligjit procedural, ndërsa pretendimet e ngritura në rekurs që ngrenë çështje të vlerësimit të provave dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 00-2022-1130, datë 13.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, faqja 5*).

11. Në datën 1.9.2022 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë sipas objektit. Në datën 1.12.2022 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë të dokumenteve.

12. Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 503, datë 13.9.2017, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”, të shfuqizuar më vonë me vendimin nr. 110, datë 2.3.2022 të tij, i ka kaluar MFE-së kompetencat e MZHETS-së. Për këtë shkak, në tekstin e këtij vendimi, emrat e këtyre institucioneve janë përdorur në përkëmbim respektiv të njëri-tjetrit, duke iu referuar kohës që janë kryer veprime prej tyre.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

13. *Kërkuesja*, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i janë cenuar:

13.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

13.1.1. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Gjykata Administrative e Apelit ka shqyrtuar ankimin e MZHETS-së të paraqitur tej afatit ligjor 15-ditor. Gjykata nuk ka hetuar për faktin e ekzistencës së dy shënimeve për datën e depozitimit të ankimit, mosekzistencën e zarfit postar të dërgimit të tij, ekzistencën e dy numrave të ndryshëm protokollit në kopjen e ankimit dhe në librin e protokollit, si dhe për datën 28.5.2014 që mban vula në kopjen e ankimit. Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës ka marrë formë të prerë dhe kërkuesja ka nisur procedurat për ekzekutimin

e tij. Nga ana tjetër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në shkelje të parimit të sigurisë juridike, ka vendosur mospranimin e rekursit, pavarësisht se ai përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012.

13.1.2. *Së drejtës së aksesit*, pasi çështja është gjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit. Me qëllim zhvillimin e debatit dhe vlerësimin e konstatimit në mënyrë të plotë dhe të saktë për datën e paraqitjes së ankimit, Gjykata Administrative e Apelit duhej ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore me prani të palëve, çka nuk është riparuar as nga Gjykata e Lartë.

13.1.3. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, në drejtim edhe të *së drejtës së mbrojtjes*, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk ka marrë parasysh dhe nuk ka trajtuar në vendim çështjet ligjore procedurale civile dhe administrative të paraqitura nga kërkuesja në datën 15.4.2015. Ajo nuk ka bërë analizë të kundërshtimeve të paraqitura prej saj, nuk ka administruar në gjykim dokumentacionin e provat e nevojshme për sqarimin e afatit të depozitimit të ankimit, si dhe nuk ia ka nënshtruar ato debatit gjyqësor. Kjo nuk është riparuar as nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

13.1.4. *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e pavarur*, si rrjedhojë e veprimeve të kancelares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, e cila në datën e depozitimit të ankimit ka qenë në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Shënimet për paraqitjen e ankimit të ministrisë brenda afatit janë vendosur qëllimisht prej saj në dosjen gjyqësore të themelit, çka ka cenuar pavarësinë e pushtetit gjyqësor, në shkelje të neneve 7 dhe 135, pika 1, të Kushtetutës. Zarfi i datës 5.9.2014, i vendosur në dosje i përket gjykimit tjetër të iniciuar nga ministria për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

13.1.5. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk ka trajtuar në vendim çështjet ligjore të paraqitura nga kërkuesja, ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është shprehur në mënyrë standarde, pa një analizë juridiko-ligjore të çështjes, pa bërë interpretim ligjor të konfliktit në raport me faktet, provat dhe ligjin e zbatueshëm, si dhe nuk u ka dhënë përgjigje të arsytuar pretendimeve të saj, që kishin të bënin me zbatimin e gabuar të ligjit procedural.



13.2. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, pasi pretendimet e saj të datës 15.4.2015 janë vlerësuar përciptazi nga Gjykata Administrative e Apelit, duke favorizuar palën e paditur, përmes shqyrtimit të ankimit të saj të paraqitur jashtë afatit ligjor. I njëjti qëndrim është mbajtur edhe nga Gjykata e Lartë, e cila ka favorizuar MZHETS-në, duke mbajtur standard të dyfishtë mes subjekteve private dhe institucioneve publike. Kërkuesja është vendosur në kushte pabarazie edhe në raport me shtetas të tjerë, të cilëve u është pranuar rekursi kur ankimi i institucionit është paraqitur jashtë afatit, duke u vendosur kthimi i çështjes për rigjykim në apel.

13.3. *E drejta e pronës*, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, duke i mohuar të drejtën për përfitimin e vlerave financiare të pagës, si rrjedhojë e largimit të padrejtë nga detyra, çka ndikon në shumën e përfituar nga sigurimet shoqërore pas mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë.

14. *Subjekti i interesuar, MFE-ja*, i përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se:

14.1. Pretendimi i kërkueses për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* është i pabazuar. Ajo nuk ka paraqitur argumente të qarta dhe të lidhura në mënyrë direkte me pretendimin për shqyrtimin e ankimit të paraqitur tej afatit ligjor. Argumentet e parashtruara prej saj i përkasin juridiksionit të gjykatave më të ulëta dhe jo atij kushtetues. Në rastin konkret nuk bëhet fjalë për gjë të gjykuar, por për një proces gjyqësor të shqyrtuar në të tria shkallët e gjykimit. Ndërkohë që është e vërtetë se në dosjen gjyqësore është paraqitur vendimi i formës së prerë i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, por kundër këtij vendimi është bërë ankim brenda afatit ligjor nga MFE-ja, i cili është depozituar gabimisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, çka është arsyetuar edhe nga gjyqtari i vetëm i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, që ka vendosur pranimin e ankimit. Ky fakt është analizuar e arsyetuar më tej edhe në vendimin e gjykatës së apelit.

14.2. Pretendimi i kërkueses për *cenimin e së drejtës së aksesit* është haptazi i pabazuar. Gjykimi i çështjes në dhomën e këshillimit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë përcaktohet shprehimisht në nenin 61 të ligjit nr. 49/2012.

14.3. Pretendimet e kërkueses për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit* janë përsëritje e pretendimeve të tjera të parashtruara për vendimmarrjet e gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë. Sekretaria e Gjykatës së Lartë ka kryer njoftimin për gjykimin e çështjes në dhomën e këshillimit në përputhje me ligjin, përmes shpalljes publike. Vendimmarrja e gjykatave bazohet në legjislacionin konkret, provat e ndodhura në dosje e në bindjen e tyre të brendshme dhe jo në pretendimet e parashtruara nga palët.

14.4. Gjykatat kanë respektuar *standardin e arsytimit të vendimit*, duke i dhënë përgjigje të argumentuar kërkueses për kushtet e pranueshmërisë dhe ligjshmërinë e ankimit të ministrisë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueses

15. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me iniciimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

16. Si bartëse e të drejtave kushtetuese kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

17. Një kriter tjetër që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1,



shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, ka të bëjë me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike efektive të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ i t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në thelb (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 8, datë 19.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret, kërkuesja ka kundërshtuar në Gjykatë vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Gjykatës së Lartë që kanë vendosur për çështjen e largimit të saj nga puna. Vendimi i Gjykatës së Lartë ka përmbyllur procesin gjyqësor administrativ në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm. Pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues individual kërkuesja i ka ngritur, në thelb, në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, duke shteruar mjetet juridike efektive në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, përpara se t'i drejtohet Gjykatës.

19. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 13.5.2022, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 1.9.2022, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

20. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar se gjykatat kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të sigurisë juridike, së drejtës së aksesit, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, parimit të gjykimit nga një gjykatë e pavarur, standardit të arsytimit të vendimit, si dhe parimin e barazisë përpara ligjit e të drejtën e pronës.

21. Kështu, sipas kërkueses, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë cenuar të drejtën e aksesit për shkak të gjykimit të çështjes në dhomën e këshillimit. Gjykata vëren se nenet 49 dhe 61 të ligjit nr. 49/2012 kanë përcaktuar shqyrtimin e

çështjeve nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë, si rregull, në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve dhe në seancë gjyqësore me prani të palëve në rastet e parashikuara nga nenet 51, pika 1 dhe 62, pika 1, të po këtij ligji. Duke pasur parasysh parashikimet ligjore konkrete dhe faktin që pretendimet e parashtruara nga kërkuesja në gjykimin në apel dhe në Gjykatën e Lartë janë marrë parasysh nga këto gjykata, Gjykata vlerëson se kërkuesja nuk ka arritur të përcaktojë cenimin e së drejtës së aksesit si rrjedhojë e gjykimit të çështjes në dhomën e këshillimit. Nga ana tjetër, ashtu siç Gjykata është shprehur në jurisprudencën e saj, procesi gjyqësor konsiderohet i rregullt, për sa kohë që në një shkallë gjykimi është zhvilluar në seancë gjyqësore publike, gjatë së cilës kërkueses i është dhënë mundësia për t'u dëgjuar dhe mbrojtur (*shih vendimin nr. 28, datë 1.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Po kështu, Gjykata vëren se pretendimet e kërkueses për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e pavarur ngrihen ndaj veprimeve të kancelares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, roli i së cilës është administrativ. Për më tepër, gjyqtari i vetëm ka shqyrtuar kushtet formale të pranimit të ankimit të ministrisë, përfshirë edhe veprimet administrative të kancelares e të sekretarisë gjyqësore, duke mbajtur qëndrim konkret për pranimin e ankimit, ndaj, në rastin konkret, nuk vërehet se si veprimet e kancelares të kenë cenuar pavarësinë e gjykatës. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses për cenimin e këtij parimi nuk janë ngritur në nivel kushtetues.

23. Në vijim, Gjykata vlerëson se edhe pretendimi i kërkueses për cenimin e parimit të barazisë para ligjit, si rrjedhojë e shqyrtimit të ankimit të ministrisë të paraqitur jashtë afatit ligjor, nuk është ngritur në nivel kushtetues.

24. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkueses për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të sigurisë juridike, parimit të barazisë së armëve e kontradiktoritetit dhe standardit të arsytimit të vendimit, si dhe për cenimin e së drejtës së pronës, duke mbajtur në konsideratë thelbin e tyre, Gjykata vlerëson t'i analizojë ato në vijim, në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike, si aspekt i së drejtës për proces të rregullt ligjor.

B. Për themelin e pretendimeve

*B.1. Për cenimin e parimit të sigurisë juridike*

25. Kërkuesja ka pretenduar se Gjykata Administrative e Apelit ka shqyrtuar ankimin e MZHETS-së, pavarësisht paraqitjes së tij tej afatit ligjor 15-ditor, edhe pse ka evidentuar mungesën e zarfit përmes të cilit pretendohet se ai është depozituar gabimisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke mos marrë parasysh shkresën e kancelares së asaj gjykate, sipas së cilës rezultonte se ankimi ishte depozituar jashtë afatit. Po kështu, gjykata nuk ka hetuar faktin e ekzistencës së dy shënimeve për datën e depozitimit të ankimit, mosekzistencën e zarfit postar të dërgimit të tij, ekzistencën e dy numrave të ndryshëm protokollit në kopjen e ankimit dhe në librin e protokollit, si dhe për datën 28.5.2014 që mban vula në kopjen e ankimit. Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës ka marrë formë të prerë dhe kërkuesja ka nisur procedurat për ekzekutimin e tij. Nga ana tjetër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në shkelje të parimit të sigurisë juridike, ka vendosur mospranimin e rekursit, pavarësisht se ai përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012. Gjykata e apelit nuk ka marrë parasysh dhe nuk ka trajtuar në vendim çështjet ligjore të parashtruara prej saj, nuk ka administruar dokumentacionin ose provat e nevojshme për sqarimin e afatit të depozitimit të ankimit, nuk ia ka nënshtruar ato debatit gjyqësor, si dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të saj, çka nuk është riparuar as nga Gjykata e Lartë.

26. Subjekti i interesuar, MFE-ja, ka prapësuar se kërkuesja nuk ka paraqitur argumente të qarta dhe të lidhura në mënyrë direkte me pretendimin për shqyrtimin e ankimit të paraqitur tej afatit ligjor. Argumentet parashtruara prej saj i përkasin juridiksionit të gjykatave më të ulëta dhe jo atij kushtetues. Në rastin konkret nuk bëhet fjalë për gjë të gjykuar, por për një proces gjyqësor të shqyrtuar në të tria shkallët e gjykimit. Ndërkohë që është e vërtetë se në dosjen gjyqësore është paraqitur vendimi i formës së prerë i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, kundër këtij vendimi është bërë ankim brenda afatit ligjor nga MFE-ja, i depozituar gabimisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, çka është arsyetuar edhe nga gjyqtari i vetëm i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, që ka vendosur pranimin e ankimit. Ky fakt është

analizuar e arsyetuar më tej edhe në vendimin e gjykatës së apelit. Gjykatat kanë dhënë përgjigje të argumentuar për kushtet e pranueshmërisë dhe ligshmërinë e ankimit të ministrisë.

27. Për sa i përket procesit të rregullt ligjor, siguria juridike është parë nga Gjykata në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, e cila nënkupton që në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Kur vendimi ka marrë formë të prerë, ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimet nr. 10, datë 7.3.2023; nr. 11, datë 16.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në funksion të parimit të sigurisë juridike, Gjykata ka pranuar se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve ligjore të përcaktuara. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën një qëllim në vetvete, por bëhet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Mospërcaktimi i këtyre afateve do të çonte në një situatë të tillë, ku konfliktet gjyqësore asnjëherë nuk do të zgjidheshin përfundimisht mes palëve dhe situata e tyre do të ishte e pasigurt, pasi në çdo moment, një e drejtë e fituar me një vendim gjyqësor, potencialisht do të mund të cenohej ose prekej me një vendim të dhënë nga një gjykatë më e lartë (*shih vendimet nr. 29, datë 15.5.2014; nr. 5, datë 2.3.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Vendosija e afateve ligjore kohore synon garantimin e parimit të sigurisë juridike, miradministrimin e drejtësisë, realizimin e një procesi të rregullt ligjor, dhënien e drejtësisë në kohën e duhur, si dhe shmangien e abuzimit me të drejtat (*shih vendimet nr. 9, datë 7.2.2017; nr. 26, datë 15.12.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjykata vëren se neni 44 i ligjit nr. 49/2012, në fuqi në kohën e paraqitjes së ankimit dhe aktualisht, referon në KPC në lidhje me afatet e ankimit. Kështu, sipas neneve 148 dhe 149 të po këtij kodi, kur afati është caktuar me ditë dhe me orë, përjashtohet dita dhe ora në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati dhe ai nuk quhet i humbur kur kërkesa ose akti është dërguar me postë edhe në ditën e fundit të afatit.



30. Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata eidenton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë së kërkuases, rikthimin e saj në pozicionin e punës, detyrimin e MZHETS-së t'i paguajë pagën dhe përfitimet e tjera nga momenti i shkëputjes së marrëdhënieve financiare deri në momentin e rikthimit në detyrë, si dhe rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër të objektit. Në kushtet kur nuk ka rezultuar ankim i paraqitur ndaj këtij vendimi nga palët, kërkuësja është pajisur nga kancelarja e gjykatës me kopje të tij me shënimin “Vendimi mori formë të prerë”, duke vijuar edhe me procedurat për vënien e tij në ekzekutim.

31. Nga dosja gjyqësore e tërhequr për qëllime të gjykimit kushtetues të çështjes, Gjykata konstaton se në datën 26.5.2014, MZHETS-ja ka ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke e dorëzuar atë në postë. Ky ankim, ndërkohë që duhej t'i dërgohej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, i është dërguar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila, më pas, në datën 4.9.2014, ia ka përcjellë për veprime Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Për shkak të veprimeve përmbarimore, pasi ka ardhur në dijeni të faktit se ankimi nuk ka mbërritur në kohën e dërgimit të tij në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, MZHETS-ja ka dërguar përsëri me postë ankimin pranë kësaj të fundit, shoqëruar me dokumente shkruesore në funksion të vërtetimit të datës së dërgimit të tij në postë. Afati i paraqitjes së ankimit është verifikuar nga gjyqtari i vetëm i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, duke arritur në përfundimin se ankimi është paraqitur në afat, referuar datës së dërgimit në postë, më 26.5.2014. Ankimi i është njoftuar menjëherë kërkuases, e cila ka paraqitur kërkesë për mospranimin e tij, për shkak të paraqitjes jashtë afatit ligjor 15-ditor, si dhe kundërankim (*shih dosjen gjyqësore nr. 601, datë 12.5.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, faqet 35–39 dhe 42–50*). Gjykata Administrative e Apelit ka shqyrtuar ankimin e MZHETS-së, ku në konsideratë të kërkesës së kërkuases për mospranimin e tij, ka arritur në përfundimin se kërkesa e saj është e pabazuar, duke vlerësuar se ankimi i MZHETS-së është paraqitur në afat, sikurse me të drejtë ka pranuar edhe gjyqtari i

vetëm i gjykatës së shkallës së parë. Pas shqyrtimit të çështjes në themel për ankimin e MZHETS-së dhe kundërankimin e kërkuases, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuases. Për rekursin e kërkuases, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, duke arsyetuar se vendimi i gjykatës së apelit është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të kërkesave të ligjit procedural, ndërsa pretendimet e ngritura në rekurs, që ngrenë çështje të vlerësimit të provave, dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të saj.

32. Duke pasur parasysh pretendimet e parashtruara nga palët në çështjen konkrete, Gjykata sjell në vëmendje jurisprudencën e saj, sipas së cilës kontrolli i kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor vlerësohet në një kontekst të caktuar faktesh, që lidhen me të drejtën për proces të rregullt ligjor dhe marrja e vendimit për çështje kushtetuese kushtëzohet nga përcaktimi i fakteve kushtetuese, mbi bazën e të cilave vlerësohet respektimi i kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 20, datë 22.9.2022; nr. 39, datë 5.5.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Ky kontroll është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2021; nr. 9, datë 26.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në këtë kuptim, përcaktimi nëse në rastin e kërkuases MZHETS-ja ka respektuar ose jo afatet ligjore për paraqitjen e ankimit përfshihet në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, ndërsa roli i Gjykatës është të përcaktojë nëse interpretimi i bërë nga këto gjykata është në përputhje me Kushtetutën, si dhe nëse kërkuases i është dhënë mundësi efektive për kundërshtimin e vendimit të gjyqtarit të vetëm të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, që ka pranuar ankimin e ministrisë. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata konstaton se verifikimi nëse ankimi i MZHETS-së është paraqitur brenda afatit ligjor është bërë fillimisht nga gjyqtari i vetëm i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, i cili e ka vlerësuar atë si të paraqitur në afat. Në vijim, përmbushja e këtij detyrimi ligjor është marrë në



shqyrtim edhe nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka vlerësuar se trajtimi i këtij fakti bie brenda juridiksionit të saj. Në këto kushte, për qëllime të gjykimit administrativ, gjykata ka administruar provat e nevojshme për përcaktimin e datës së saktë të depozitimit të ankimit nga ministria. Në analizë të këtyre provave, të pretendimeve të palëve, si dhe bazuar në legjislacionin procedural në fuqi, gjykata e apelit ka vlerësuar se ankimi është depozituar në afat, duke e gjetur të drejtë vlerësimin e bërë nga gjyqtari i vetëm. Interpretimi i dispozitave ligjore për afatin e paraqitjes së ankimit i bërë nga gjykata e apelit është marrë në shqyrtim edhe nga Gjykata e Lartë, e cila e ka vlerësuar atë në respektim dhe zbatim të drejtë të kërkesave të ligjit procedural.

34. Në këndvështrim të sa më sipër dhe në analizë të fakteve kushtetuese në rastin konkret, Gjykata evidenton se kërkuases i është dhënë mundësia të parashtrijë në gjykatat e zakonshme pretendimet e saj për paraqitjen e ankimit të MZHETS-së jashtë afatit. Brenda kompetencave të tyre, gjykatat kanë përcaktuar datën e depozitimit të ankimit dhe në interpretim e zbatim të legjislacionit në fuqi kanë dhënë përgjigje të arsyetuar për vendimmarrjet e tyre. Ndonëse Gjykata e Lartë ka arsyetuar në mënyrë të përgjithshme për pretendimet e kërkuases për cenimin e parimit të sigurisë juridike, Gjykata vëren se ajo ka marrë përgjigje për to edhe nga kjo gjykatë (*shih vendimin nr. 00-2022-1130, datë 13.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, faqja 6, pikat 13 dhe 14*).

35. Për sa më lart, Gjykata vëren se gjykatat kanë vënë në balancë pretendimet e kërkuases në lidhje me parimin e sigurisë juridike përkundrajt së drejtës së aksesit në gjykatë të palës së paditur. Interpretimi që gjykatat u kanë bërë fakteve të çështjes lidhur me datën e depozitimit të ankimit nga pala e paditur, nuk rezulton të jetë arbitrar në kuptimin kushtetues, dhe në këtë mënyrë as të ketë cenuar të drejtat kushtetuese të kërkuases. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se gjykatat e zakonshme kanë vepruar në respektim të së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe pretendimi i kërkuases për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar.

36. Në përfundim, Gjykata çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuases, sipas arsyetimit të mësipërm, është i pabazuar, ndaj duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 18.5.2023.

Shpallur më 19.6.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahim

VENDIM

Nr. 28, datë 18.5.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Elsa Toska,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 18.5.2023, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 27 (A) 2022 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Aleks Lici, Lefteria Lici

SUBJEKT I INTERESUAR: Telemah Rajdho, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-2166 (79), datë 7.3.2022, të Kolegjit Civil të



Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 5, 7, 15, 17, 33, 42, 43, 116, 122, 31, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I”, 135, 142 dhe 145, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 6 dhe 13, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 49, pika 3, shkronja “e”, 71 dhe 71/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000),

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësit Aleks Lici dhe Lefteria Lici janë bashkëshortë. Kjo e fundit është motra e shtetasit Telemah Rajdho. Sipas kontratës noteriale të shitjes nr. 2035 rep. dhe nr. 881 kol., datë 9.10.2000, (kontrata e shitjes së truallit), kërkuësit dhe subjekti i interesuar kanë blerë nga Këshilli i Qarkut Gjirokastrë (seksioni i financës) truallin me sipërfaqe 1380 m², të ndodhur në Gjirokastrë. Më herët, për këtë truall, Këshilli i Rregullimit të Territorit (KRRT) pranë Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, me vendimin nr. 15, datë 13.4.1993, ka miratuar sheshin e ndërtimit dhe, më pas, me vendimin nr. 14, datë 8.4.1998, ka miratuar dhënien e lejes së ndërtimit për objektin “lokal dhe banesë”. Në vijim, me vendimin nr. 1, datë 24.7.2003, KRRT-ja, Gjirokastrë ka miratuar sheshin dhe lejen e ndërtimit për objektin “shtesë anësore lokale e banese në të dyja krahët në pronë të vet”. Pas ndërtimit të objektit dhe shtesave anësore mes kërkuësve dhe subjektit të interesuar kanë lindur mosmarrëveshje në lidhje me pronësinë e truallit dhe objektit të ndërtuar mbi të, që posedoheshin nga kërkuësit, të cilët pretendonin se ishin pronarë të vetëm të kësaj pasurie.

2. Për sa më sipër, nga viti 2006 e në vijim janë zhvilluar disa procese gjyqësore, prej të cilave kërkuësit, kanë kundërshtuar procesin e katërt gjyqësor, i cili është edhe objekt i këtij gjykimi kushtetues (shih paragrafët 10–19 të këtij vendimi). Duke qenë se faktet dhe rrethanat e procesit të kundërshtuar nga kërkuësit lidhen edhe me faktet dhe rrethanat e proceseve të tjera gjyqësore, në vijim të këtij vendimi do të pasqyrohen të gjitha proceset gjyqësore që lidhen me çështjen objekt i këtij gjykimi kushtetues.

a) Procesi i parë civil (procesi kryesor me objekt njohjen e bashkëpronësisë)

3. Sipas akteve të dosjes gjyqësore rezulton se subjekti i interesuar ka paraqitur padi në gjykatë kundër kërkuësve, duke kërkuar detyrimin e tyre ta njihnin bashkëpronar mbi pasurinë truall dhe ndërtesë. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 2209, datë 15.12.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka vendosur pranimin e padisë. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë kanë paraqitur ankim në gjykatën e apelit të dyja palët ndërgjyqëse.

4. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 113, datë 18.3.2009, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2209, datë 15.12.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Ndër të tjera, gjykata e apelit ka arsyetuar se nuk qëndronte pretendimi i kërkuësve për falsitetin dhe pavlefshmërinë e pjeshme të kontratës së shitjes së truallit për sa i përkiste paditësit Telemah Rajdho (për shkak të mosregjistrimit të saj referuar paragrafit të parë të nenit 83 të Kodit Civil), pretendim ky që, sipas saj, as nuk ishte kundërshtuar gjyqësisht sipas rregullave procedurale (si pavlefshmëri relative e pretenduar). Kundër vendimit të gjykatës së apelit kanë bërë rekurs të dyja palët ndërgjyqëse dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2011-2, datë 14.1.2011, ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

b) Procesi i dytë civil (me objekt njohjen e pavërtetësisë së dokumenteve “Kërkesë për leje ndërtimi” dhe “Leje ndërtimi” (formulari nr. 4)

5. Ndërsa procesi kryesor ndodhej në gjykatën e apelit, në datën 27.2.2009, kërkuësi Aleks Lici ka paraqitur padi kundër subjektit të interesuar Telemah Rajdho dhe Këshillit të Rrethit



Gjirokastrë, person i tretë Lefteria Lici, me objekt: “Njohje e pavërtetësisë së dokumenteve “Kërkesë për leje ndërtimi” dhe “Leje ndërtimi nr. 379 prot., datë 15.5.1998 (formulari nr. 4).”.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. 1017, datë 29.5.2009, ka vendosur pranimin e padisë, ndërsa Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 469, datë 7.12.2009, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi Aleks Lici, për të cilin Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2011-830, datë 9.6.2011, ka vendosur mospranimin e tij.

c) Procesi i tretë civil (me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të pjesshme të kontratës së shitjes së truallit)

7. Ndërkohë që procesi kryesor ndodhej në Gjykatën e Lartë, në datën 11.10.2010, kërkuesi Aleks Lici ka vënë në lëvizje një proces tjetër gjyqësor, duke paditur shtetasin Telemah Rajdho dhe Seksionin e Financës në Këshillin e Rrethit Gjirokastrë, person i tretë Lefteria Lici, me objekt konstatimin si absolutisht të pavlefshme të kontratës së shitjes së truallit për pjesën që i përkiste të paditurit Telemah Rajdho.

8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. 245, datë 8.3.2010, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, me arsyetimin se paditësi nuk ka parashtruar para gjykatës konflikt juridiko-civil të kërkueshëm në rrugë gjyqësore, pasi mungon kërkimi i rregullimit të pasojave juridike të krijuara si rezultat i pavlefshmërisë absolute të pretenduar.

9. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 313, datë 1.7.2011, ka vendosur pushimin e gjykimit, me arsyetimin se në rastin konkret ndodhej para një padie që nuk mund të ngrihej dhe gjykimi nuk mund të vazhdonte, pasi nuk mund të konstatohej nga gjykata pavlefshmëria e një kontrate, në rrethanat kur me vendim gjyqësor të formës së prerë (vendimi në procesin kryesor, që tashmë kishte përfunduar edhe në Gjykatën e Lartë) ishte pranuar bashkëpronësia e palëve, pra se kontrata e shitjes ishte e bazuar në ligj. Po ashtu, sipas gjykatës së apelit, edhe baza ligjore, sipas nenit 111 të KC-së, nuk qëndronte, pasi veprimi juridik ishte i pandashëm dhe nuk kishte pjesë të tij vetëm për sa i përket të paditurit Telemah Rajdho.

ç) Procesi i katërt civil objekt i këtij gjykimi kushtetues (me objekt njohjen e pavërtetësisë

së pjesshme të dokumenteve “kontratë shitje e truallit” dhe “akt vlerësimi datë 29.9.2000”, si dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të pjesshme të kontratës së shitjes së truallit)

10. Në datën 7.1.2012, kërkuesi Aleks Lici ka vënë në lëvizje një proces tjetër gjyqësor, me të paditur Telemah Rajdho, Lefteria Lici dhe Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, me objekt njohjen e pavërtetësisë së pjesshme për shkak falsiteti të kontratës së shitjes së truallit, si dhe pavërtetësinë e pjesshme të aktit noterial që i ka dhënë formë veprimit juridik, për shkak falsiteti, për pjesën që paraqitet blerës subjekti i interesuar. Gjithashtu, ai ka kërkuar edhe pavërtetësinë e pjesshme të aktit të vlerësimit të datës 29.9.2000, për shkak falsiteti, për pjesën e shkrimit dhe nënshkrimit të subjektit të interesuar (*akti i vlerësimit*), duke kërkuar papërdorshmërinë e këtij dokumenti.

11. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. 21-2012-1976/978, datë 5.11.2012, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë dhe shpalljen si të falsifikuar të kontratës së shitjes së truallit dhe aktit të vlerësimit. Sipas gjykatës së shkallës së parë kërkimi për pavërtetësinë e dokumenteve për shkak të falsitetit të kontratës së shitjes së truallit dhe aktit të vlerësimit, nuk ka qenë më parë objekt shqyrtimi gjyqësor. Për kërkimin për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të pjesshme të kontratës së shitjes së truallit, gjykata ka arsyetuar se ky kërkim ishte i njëjtë me atë të gjykuar më parë me vendim përfundimtar, midis të njëjtave palë dhe për të njëjtin shkak ligjor (vendimi nr. 245, datë 8.3.2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, i lënë në fuqi me vendimin nr. 313, datë 1.7.2011, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë), ndaj për këtë shkak ky kërkim duhej të rrëzohej.

12. Mbi bazën e ankimit të bërë nga kërkuesi Aleks Lici dhe i padituri Telemah Rajdho, vendimi nr. 21-2012-1976/978, datë 5.11.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë dhe vendimi i kësaj të fundit është shfuqizuar nga Gjykata e Lartë, e cila e ka dërguar çështjen për rigjykim.

13. Në rigjykimin e çështjes, Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 20-2017-701/378, datë 15.9.2017, ka vendosur të lërë në fuqi vendimin nr. 21-2012-1976/978, datë 5.11.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë për të gjitha disponimet e tij, përveç atij për kërkimin për



falsitet të aktit të vlerësimit dhe pasojave të këtij falsiteti si më poshtë: rrëzimin e padisë për kërkimin për falsitetin e aktit të vlerësimit dhe për papërdorshmërinë e këtij dokumenti.

14. Në vendimin e saj, lidhur me kërkimin e padisë për pavlefshmërinë absolute të pjeshme të kontratës së shitjes së truallit, gjykata e apelit ka çmuar se nuk ndodhej përpara “gjësë së gjykuar”, duke arsyetuar se në gjykimet e mëparshme nuk ishte vënë në diskutim shkaku i pretenduar në këtë gjykim nga kërkuesi për falsitetin e saj, si dhe me vendimin gjyqësor të formës së prerë, vendimin nr. 313, datë 1.7.2011, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështja ishte pushuar me arsyetimin se ishte para një padie që nuk mund të ngrihej, vendim ky që nuk mund të përbëjë “gjë të gjykuar”, sa kohë nuk ka vendosur për pranimin ose rrëzimin e padisë. Nga ana tjetër, për këtë kërkim padie, gjykata e apelit e ka gjetur të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së parë për rrëzimin e tij, me arsyetimin se gjykata nuk mund të japë vendim për deklarin si absolutisht të pavlefshëm të një veprimi juridik, për sa kohë kërkuesi nuk ka paraqitur kërkesa ose pretendime në lidhje me zgjidhjen e pasojave që vijnë nga pavlefshmëria absolute, referuar për këtë vendim të unifikues nr. 13/2006, të Gjykatës së Lartë.

15. Lidhur me kërkimin për pavërtetësinë e aktit të vlerësimit dhe papërdorshmërinë e tij, gjykata e apelit e ka gjetur të pabazuar këtë kërkim, duke arsyetuar se në konsideratë edhe të orientimit të Gjykatës së Lartë për vlerësimin e këtij dokumenti në raport me kërkesat e nenit 253 të KPC-së, ky dokument përbënte akt zyrtar me fuqi të plotë provuese dhe në këtë këndvështrim nuk rezultonte të kishte falsifikim të tij për sa i përket tërësisë së aktit, ndërsa shkaku i pretenduar nga paditësi (kërkuesi Aleks Lici) nuk lidhej me veprimet e kryera nga nëpunësi shtetëror, të cilat ishin korrekte dhe të bazuara në ligj.

16. Për sa i përket kërkimit të padisë për pavërtetësinë e kontratës së shitjes të truallit dhe papërdorshmërinë e saj, gjykata e apelit ka arsyetuar se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka shpallur tërësisht të falsifikuar këtë kontratë, pasi veprimi juridik i dokumentuar përmes saj është një veprim juridik i pandashëm, në kuptim të nenit 111 të KC-së, sikurse një gjë e tillë ishte pranuar në vendimin gjyqësor të formës së prerë, vendimin nr. 113, datë 18.3.2009, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

17. Mbi bazën e rekurseve të paraqitura nga kërkuesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-2166 (79), datë 7.3.2022, ka vendosur të ndryshojë vendimin nr. 21-2012-1976/978, datë 5.11.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe vendimin nr. 20-2017-701/378, datë 15.9.2017, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, duke rrëzuar kërkesëpadinë për njohjen e pavërtetësisë së pjeshme për shkak falsiteti dhe konstatimin pjesërisht të pavlefshmërisë absolute për shkak të kundërligjshmërisë së kontratës së shitjes së truallit. Gjykata e Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër për pjesën tjetër. Me këtë vendim, praktikisht padia e kërkuesit Aleks Lici është rrëzuar në tërësi.

18. Sipas Gjykatës së Lartë, në rastin konkret, kjo çështje përbën gjë të gjykuar, për rrjedhojë gjykata e shkallës së parë në lidhje me padinë duhej të vendoste pushimin e gjykimit. Gjithashtu, sipas Gjykatës së Lartë, gjykata e apelit nuk e ka pasur të qartë natyrën e mosmarrëveshjes, pasi nuk ka arritur të identifikojë se cili ka qenë objekti i kërkimit, shkaku i padisë dhe palët në konflikt dhe si rrjedhojë nuk ka identifikuar drejt nëse ndodhej para dy çështjeve të njëjta apo jo, për të vlerësuar nëse ishte para gjësë së gjykuar. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se është e njëjta çështje, me të njëjtat palë, me të njëjtin objekt dhe të njëjtin shkak padie sikurse çështja e mëparshme (procesi kryesor), ku padisë së paditësit Telemah Rajdho i ishte dhënë përgjigje me vendim gjyqësor të formës së prerë, ndaj, ndryshe nga sa arsyeton gjykata e apelit, ky kërkim ka rënë në prekluzivitet për kërkuesit për shkak të parimit të “gjësë së gjykuar”. Në lidhje me këtë, Gjykata e Lartë ka referuar atë që e konsideron si praktikë të konsoliduar në lidhje me konceptin “*gjë e gjykuar e heshtur*”, për të cilin është shprehur edhe më parë.

19. Në datën 7.7.2022, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në këtë Gjykatë në datën 31.10.2022. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 20.1.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 1.2.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.



II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

20. **Kërkuesit** në kërkesën drejtuar Gjykatës kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt, në drejtim të:

20.1. *Zbatimit të gabuar të parimit të gjësë së gjykuar*, pasi Gjykata e Lartë ka konsideruar “gjë të gjykuar” një çështje që nuk ka qenë asnjëherë më parë e tillë në vendimet të cilave ajo u referohet. Akti i vlerësimit është bërë objekt padie për herë të parë në procesin e katërt gjyqësor, në çështjen nr. regj. 21/21266-00003-21-2012, dhe nuk është gjykuar ndonjëherë nga vendimet e cituara nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

20.2. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar në përputhje me qëndrimet e mbajtura nga jurisprudenca kushtetuese dhe nga ajo vetë në lidhje me parimin e “gjësë së gjykuar”. Ajo nuk ka arsyetuar se përse ka vendosur ta zhvillojë gjykimin në dhomën e këshillimit dhe jo në seancë gjyqësore, si dhe nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kërkuësve. Vendimi i saj është kontradiktor, pasi për shkak të presjes që është vendosur në fjalinë e fundit nënrenditëse të dispozitivit, kuptohet sikur padia është pranuar pjesërisht, ndërkohë që shprehet ndryshe në paragrafin 33 të vendimit.

20.3. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi nuk është respektuar procedura e caktimit të shortit për përbërjen e trupit gjykues dhe e caktimit të datës së zhvillimit të gjykimit. Procedura e zhvilluar në Gjykatën e Lartë është bërë në rrethana të dyshimta dhe me parregullsi të shumta, që ngrenë dyshime për veprime të paligjshme deri në falsifikim të akteve. Asnjë nga fashikujt nuk shoqërohet me inventar për përmbajtjen e numrit të fletëve dhe nënshkrimin përkatës në inventar. Gjithashtu, gjykatat më të ulëta kanë vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë dhe mbi rekursin e kërkuësve Gjykata e Lartë, duke e konsideruar çështjen gjë të gjykuar, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, duke dalë kështu jashtë objektit të saj, në kundërshtim edhe me nenet 31 e vijues të KPC-së. Gjykata e Lartë në këtë rast ka dhënë një zgjidhje që asnjë nga palët nuk e ka kërkuar, duke përkeqësuar pozitën e kërkuësve.

20.4. *Së drejtës së mbrojtjes dhe të aksesit*, pasi kërkuësit nuk janë njoftuar për zhvillimin e gjykimit

në datën 7.3.2022. Ata nuk janë njoftuar as në adresën elektronike të përfaqësuesit të tyre, edhe pse ai e kishte lënë adresën e tij në rekurs. Gjykata e Lartë duhej ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore dhe të dëgjonte pretendimet e kërkuësve. Ajo i ka cenuar këto të drejta edhe për faktin se ka zbatuar dispozitën kalimtare që i jep të drejtë të revokojë vendimet e mëparshme të saj për shqyrtimin e çështjes në seancë me praninë e palëve. Gjithashtu, ka vendosur në kundërshtim me nenin 484 të KPC-së dhe nuk ka dhënë asnjë shkak për shtyrjen e marrjes së vendimit.

20.5. *Parimit të paanshmërisë*, pasi të njëjtët gjyqtarë që kanë shqyrtuar çështjen objekt të këtij gjykimi kushtetues, kanë pasur në shqyrtim edhe çështjen tjetër të kërkuësve nr. 1111-00027-00-2012 dhe objekt “Rishikimin e vendimeve të procesit të parë gjyqësor”. Edhe pse për këtë të fundit (çështjen me objekt rishikimin e vendimeve të procesit të parë gjyqësor) anëtarët e trupit gjykues kanë dhënë dorëheqjen, konstatohet se ajo është dhënë në datën 1.4.2022, pas dhënies së vendimit objekt të këtij ankimi kushtetues. Gjithashtu, konstatohet se megjithëse anëtarët e trupit gjykues kanë dhënë dorëheqjen, ndihmësja ligjore ka mbetur e njëjta.

20.6. *Së drejtës për një proces të drejtë*, pasi Gjykata e Lartë ka vepruar në kundërshtim me udhëzimin e ministrit të Drejtësisë nr. 353, datë 3.9.2013, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio” (*udbëzimi nr. 353/2013*), pasi nuk e ka regjistruar seancën në çështjen e kërkuësve. Gjithashtu, procesverbali i seancës është i paplotë. Po kështu, Gjykata e Lartë ka vepruar në kundërshtim me nenet 1, 4, 7, 11 etj., të KPC-së, pasi e ka shqyrtuar çështjen pa pasur në dispozicion të gjitha aktet që ndodheshin në fashikullin e gjykimit. Gjykata e Lartë ka dhënë një vendim pa u bazuar në prova dhe në ligj, si dhe pa zhvilluar një hetim të plotë e të gjithanshëm.

21. *Subjekti i interesuar, Telemah Rajdho, dhe Këshilli i Qarkut Gjirokastrë*, nuk kanë paraqitur prapësime, edhe pse janë njoftuar rregullisht nga Gjykata.



III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesësve

22. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

23. Gjykata çmon se kërkesit legjitimohen *ratione personae*, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ku është dhënë vendimi i kundërshtuar, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar.

24. Për sa i takon *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, ankuesi duhet të shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për rivendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 56, datë 25.7.2017; nr. 56, datë 21.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesit kanë kundërshtuar vendimin nr. 00-2022-2166 (79), datë 7.3.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin e katërt gjyqësor në ngarkim të tyre, për rrjedhojë Gjykata vlerëson se ata i kanë shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që pretendojnë se u janë cenuar.

26. Gjykata çmon se kërkesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, pasi vendimi më i fundit gjyqësor që ka vendosur për çështjen e tyre është i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë i datës 7.3.2022, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 7.7.2022, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

27. Për sa i përket legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, duke argumentuar, ndër të tjera, se nuk është respektuar procedura e caktimit të shortit për përbërjen e trupit gjykues dhe e caktimit të datës së zhvillimit të gjykimit. Procedura e zhvilluar në Gjykatën e Lartë është bërë në rrethana të dyshimta dhe me parregullsi të shumta, që ngrenë dyshime për veprime të paligjshme deri në falsifikim të akteve. Sipas tyre, asnjë nga fashikujt nuk shoqërohet me inventar për përmbajtjen e numrit të fletëve dhe nënshkrimin përkatës në inventar. Gjithashtu, ata kanë pretenduar cenimin e parimit të paanshmërisë, pasi të njëjtët gjyqtarë që kanë shqyrtuar çështjen objekt të këtij gjykimi kushtetues, kanë pasur në shqyrtim edhe çështjen tjetër të kërkesësve nr. 1111-00027-00-2012 dhe objekt “Rishikimin e vendimeve të procesit të parë gjyqësor”. Sipas tyre, edhe pse anëtarët e trupit gjykues kanë dhënë dorëheqjen, konstatohet se ajo është dhënë në datën 1.4.2022, pas dhënies së vendimit objekt të këtij ankimi kushtetues.

28. Për sa më sipër, referuar këtyre pretendimeve të kërkesësve, lidhur me cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, Gjykata vëren se, në ndryshim nga sa pretendojnë ata, në aktet bashkëlidhur kërkesës ndodhet edhe praktika e caktimit të relatorit të çështjes, edhe përbërja e trupit gjykues, të nënshkruara nga kancelari i Gjykatës së Lartë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Gjithashtu, rezulton se kërkesit janë njohur me përbërjen e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë dhe nuk kanë paraqitur asnjë pretendim në lidhje me të. Për këtë arsye, këto argumente të kërkesësve janë haptazi të pabazuara.

29. Ndërsa, për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të paanshmërisë, Gjykata konstaton se, ashtu siç edhe ka parashtruar kërkesi, anëtarët e trupit gjykues të Gjykatës së



Lartë, pasi kanë dhënë vendimin objekt të këtij gjykimi kushtetues, kanë dhënë dorëheqjen nga gjykimi i çështjes me objekt rishikimin e vendimeve të procesit të parë gjyqësor. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se vetëm pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në këto çështje nuk mjafton për konstatimin e cenimit të parimit të paanshmërisë, përderisa nuk ka një vendimmarrje ose vlerësim prej tyre për të dyja këto çështje. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim i kërkuësve është haptazi i papabuar.

30. Për sa i përket pretendimit të kërkuësve për cenimin e së drejtës për një proces të drejtë, për shkak se nuk është zbatuar udhëzimi nr. 353/2013, si dhe janë cenuar nenet 1, 4, 7, 11 etj., të KPC-së, pasi Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen pa pasur në dispozicion të gjitha aktet që ndodheshin në fashikullin e gjykimit, Gjykata rithekson qëndrimin e saj të konsoliduar se interpretimi dhe zbatimi i ligjit, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave, janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Gjykata ndërhyr kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, kanë cenuar të drejtat kushtetuese të palëve. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuësve ka të bëjë, në thelb, me çështje të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, ndërkohë që ata nuk kanë arritur ta ngrenë atë në nivel kushtetues, pra të tregojnë cenimin e ardhur në të drejtat e tyre kushtetuese nga kjo veprimtari.

31. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuësve, Gjykata vëren se ata kanë pretenduar se është zbatuar gabim parimi i gjësë së gjykuar, për shkak se Gjykata e Lartë ka konsideruar “gjë të gjykuar” një çështje që nuk ka qenë asnjëherë më parë e tillë në vendimet të cilave ajo u referohet, si dhe standardi i arsyetimit të vendimit, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar në përputhje me qëndrimet e mbajtura nga jurisprudenca kushtetuese dhe nga ajo vetë në lidhje me parimin e “gjësë së gjykuar”. Për rrjedhojë, këto pretendime, për nga thelbi dhe natyra e tyre, Gjykata vlerëson që të trajtohen në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me

zbatimin e parimit të gjësë së gjykuar. Këto pretendime të kërkuësve, bashkë me pretendimet e tjera të tyre, që kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga gjë gjykatë e caktuar me ligj, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, duke dalë jashtë objektit të saj, së drejtës së aksesit dhe së drejtës së mbrojtjes do të shqyrtohen në vijim nga Gjykata për bazueshmërinë e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e standardit të arsyetimit lidhur me zbatimin e parimit të gjësë së gjykuar

32. Kërkuësit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë ka gabuar në arsyetimin e saj, pasi ka quajtur gjë të gjykuar një çështje e cila nuk ka qenë asnjëherë më parë gjë e gjykuar në vendimet të cilave u referohet ajo gjykatë, si dhe nuk ka arsyetuar në përputhje me qëndrimet e mbajtura nga jurisprudenca kushtetuese dhe nga vetë ajo në lidhje me gjënë e gjykuar. Gjithashtu, ajo nuk ka arsyetuar pse ka vendosur ta zhvillojë gjykimin në dhomën e këshillimit dhe jo në seancë, si dhe nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kërkuësve. Sipas tyre, vendimi është kontradiktor, sepse për shkak të presjes që është vendosur në fjalinë e fundit nënrenditëse të dispozitivit, kuptohet sikur është pranuar padia pjesërisht, ndërkohë që paragrafi 33 i vendimit shprehet ndryshe. Ata kanë pretenduar se nuk ndodhen përpara gjësë së gjykuar, pasi akti i vlerësimit është bërë objekt padie për herë të parë në procesin e katërt gjyqësor, në çështjen nr. regj. 21/21266-00003-21-2012, si dhe nuk është gjykuar ndonjëherë në vendimet e cituara nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

33. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 11, datë 10.3.2023; nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Në këtë drejtim, vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i



qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 11, datë 10.3.2023; nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 19, datë 1.4.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Duke iu rikthyer rastit konkret, Gjykata vëren se, referuar procesit të parë gjyqësor, kontrata e shitjes së truallit ose elemente të saj nuk kanë qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor. Në këtë proces nga kërkuesit është ngritur pretendimi për falsitetin dhe pavlefshmërinë e pjesshme të kontratës së shitjes së truallit, por gjykata, për arsye procedurale, nuk e kanë marrë në shqyrtim atë, duke mos u shprehur për të dhe për elementet e vlefshmërisë së saj. Në procesin e dytë gjyqësor rezulton se kontrata e shitjes së truallit nuk ka qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe palët nuk kanë ngritur pretendime për të. Ndërkohë, referuar procesit të tretë gjyqësor, Gjykata konstaton se kontrata e shitjes së truallit ka qenë objekt gjykimi, por përsëri, për arsye procedurale, nuk është shqyrtuar themeli i çështjes dhe gjykata nuk janë shprehur në lidhje me elementet e vlefshmërisë së saj. Për sa i takon procesit të katërt gjyqësor, Gjykata evidenton se objekt i këtij procesi ka qenë kontrata e shitjes së truallit dhe akti i vlerësimit. Po ashtu, Gjykata konstaton se akti i vlerësimit nuk ka qenë objekt shqyrtimi në asnjë prej proceseve gjyqësore (procesi i parë, dytë dhe i tretë) të mëparshme të zhvilluara nga të njëjtat palë dhe është bërë objekt gjykimi për herë të parë në procesin e katërt gjyqësor, i cili është edhe objekt i këtij gjykimi kushtetues.

36. Referuar procesit të katërt gjyqësor, rezulton se gjykata e shkallës së parë pretendimin për pavlefshmërinë e kontratës e ka konsideruar gjë të gjykuar, ndërsa gjykata e apelit ka mbajtur qëndrim të kundërt me atë të gjykatës të shkallës së parë. Pas rekursit të paraqitur nga kërkuesit, Kolegji Civil i

Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e padisë së tyre, duke e quajtur çështjen në tërësi gjë të gjykuar, përfshirë këtu edhe pretendimin për aktin e vlerësimit. Sipas arsyetimit që ka bërë Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, kjo çështje është gjykuar më parë, duke iu referuar procesit të tretë gjyqësor, dhe ajo është pushuar për shkak se nuk mund të konstatohet pavlefshmëria e kontratës kur ka një vendim gjyqësor të formës së prerë për njohjen si bashkëpronar, si dhe të gjitha pretendimet e kërkuesve lidhur me kontratën i janë nënshtruar më parë bisedimit dhe kanë marrë zgjidhje me një vendim që ka marrë formë të prerë.

37. Në lidhje me parimin e gjësë së gjykuar, Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se kufijtë e zbatimit të këtij parimi përcaktohen në lidhje të ngushtë me thelbin e mosmarrëveshjes në gjykim. Në këtë aspekt, Gjykata ka çmuar se gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim dhënien e vendimit gjyqësor dhe t'u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimet nr. 42, datë 27.12.2022; nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 29, datë 21.12.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Për sa më sipër, në kuptim të parimit të gjësë së gjykuar, bazuar në faktet e kësaj çështjeje dhe referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore që kanë shqyrtuar këtë mosmarrëveshje, Gjykata vëren se nuk rezulton që nga gjykata t'u jenë dhënë përgjigje përfundimtare elementeve të pavlefshmërisë së kontratës së shitjes së truallit. Në procesin e parë civil gjykata e zakonshme nuk e kanë marrë në shqyrtim këtë pretendim, pasi, sipas tyre, ai nuk ishte ngritur në formën e kërkuar nga ligji, ndërsa në procesin e tretë civil ato kanë arsyetuar se pavlefshmëria e kontratës së shitjes së truallit nuk mund të konstatohet me vendim gjykate, kur më parë po me vendim gjykate është pranuar bashkëpronësia. Po ashtu, edhe pretendimit tjetër i kërkuesve për pavërtetësinë e pjesshme të aktit të vlerësimit, nuk rezulton t'i jetë dhënë përgjigje më parë nga gjykata.

39. Për sa më sipër, Gjykata çmon se i takonte Gjykatës së Lartë, në përputhje me rolin e saj *subsidiar*, të bënte një analizë të plotë dhe shteruese të fakteve dhe qëndrimeve të gjykatave të



zakonshme përgjatë proceseve gjyqësore mes palëve ndërgjyqëse, për të arritur në një përfundim të drejtë në lidhje me ekzistencën ose jo të gjësë së gjykuar në rastin konkret, qoftë për kontratën e shitjes së truallit, qoftë për aktin e vlerësimit. Pavarësisht se Gjykata e Lartë në vendimin e saj ka vlerësuar se kërkitimi i kërkuësve për kontratën e shitjes së truallit ka rënë në prekluzivitet, pasi në rastin konkret ndodhemi para “gjësë së gjykuar të heshtur”, ajo për të arritur në këtë përfundim i është referuar procesit të parë civil (procesi kryesor me objekt njohjen e bashkëpronësisë), por nuk ka arritur të arsyetojë në drejtim të fakteve të vërtetuara dhe së drejtës së zbatuar që u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj.

40. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuësve për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e gjësë së gjykuar është i bazuar dhe duhet pranuar.

41. Në kushtet kur vendimi gjyqësor i kundërshtuar duhet shfuqizuar, pasi është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor, dhe çështja do të merret përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, Gjykata çmon të mos shprehet për pretendimet e tjera të kërkuësve, që kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, së drejtës së aksesit dhe së drejtës së mbrojtjes.

42. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa është e bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-2166 (79), datë 7.3.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së

Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 18.5.2023.

Shpallur më 19.6.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Marjana Semini, Sandër Beci, Genti Ibrahim

MENDIM PARALEL

1. Në çështjen nr. 27 (A) 2022, me kërkuës Aleks Lici dhe Lefteria Lici, i bashkohemi shumicës në lidhje me zgjidhjen e kësaj çështjeje, për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-2166 (79), datë 7.3.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë. Megjithatë, në vlerësimin tonë, Gjykata nuk duhej ta trajtonte çështjen në drejtim të pretendimit për cenimin e standardit të arsyetimit të lidhur me parimin e gjësë së gjykuar, por në drejtim të pretendimit të kërkuësve për tejkalimin e kufijve të shqyrtimit të rekursit nga Gjykata e Lartë, çka përbënte bazë të mjaftueshme për ta bërë të cenueshëm atë vendim pa u ndalur në bazueshmërinë e pretendimeve të tjera të parashtruara në këtë kërkesë.

2. Kërkuësit kanë pretenduar se edhe pse gjykatat më të ulëta kanë vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, Gjykata e Lartë, e vënë në lëvizje mbi rekursin e tyre, duke e konsideruar çështjen gjë të gjykuar, ka vendosur rrëzimin tërësisht të kërkesëpadisë, duke kapërcyer kështu kufijtë e shkaqeve të parashtruara në rekurs. Sipas tyre, Gjykata e Lartë ka dhënë një zgjidhje që asnjë nga palët nuk e ka kërkuar, duke përkeqësuar pozitën e kërkuësve mbi rekursin e tyre (*shih paragrafin 20.3. të vendimit*). Në lidhje me këtë pretendim, shumica, duke e trajtuar në këndvështrim të standardit të gjykatës së caktuar me ligj, ka arsyetuar se “*në kushtet kur vendimi gjyqësor i kundërshtuar duhet shfuqizuar, pasi është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor, dhe çështja do të merret përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, Gjykata çmon të mos*



shprehet për pretendimet e tjera të kërkuësve, që kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, së drejtës së aksesit dhe së drejtës së mbrojtjes” (shih paragrafin 41 të vendimit).

3. Për rrjedhojë, Gjykata e ka lënë pa përgjigje këtë pretendim të kërkuësve, edhe pse në vlerësim tonë shqyrtimi i tij ishte i nevojshëm, pasi do e çonte atë në një qëndrim të drejtë në lidhje me këtë çështje. Kjo, sepse në rast se Gjykata do e gjente të drejtë këtë pretendim, pra nëse do arrinte në përfundimin se Gjykata e Lartë ka dalë tej shkaqeve të aktit mbi të cilin është vënë në lëvizje, do të ishte i panevojshëm çdo vlerësim i mëtejshëm i pretendimeve të kërkuësve, pasi kjo do ta detyronte atë gjykatë të rigjykonte çështjen duke u shprehur edhe një herë në lidhje me bazueshmërinë e shkaqeve të parashtruara në rekurs. Vetëm nëse do e vlerësonte të pabazuar këtë pretendim, Gjykata do të mund të vijonte më tej me vlerësimin e pretendimeve të tjera, pra edhe të atij për cenimin e parimit të gjësë së gjykuar. Mosdhënia përgjigje këtij pretendimi, në situatën që çështja është kthyer për rishqyrtim në Kolegjin Civil, mund të çojë sërish në cenimin e të drejtave të kërkuësve në drejtim të kufijve të shqyrtimit të saj.

4. Për më tepër, në vlerësimin tonë, ky pretendim i kërkuësit është i bazuar edhe në themel, pasi edhe pse është vënë në lëvizje mbi bazën e rekursit të paditësit Aleks Lici (e paditura Lefteria Lici ka paraqitur rekurs për të njëjtat shkaqe dhe kërtime), Gjykata e Lartë ka vendosur në përfundim rrëzimin praktikisht të padisë në tërësinë e saj, duke cenuar edhe atë pjesë të vendimeve gjyqësore që ka vendosur në favor të palës rekursuese. Kërkuësi nuk ka përcaktuar standardin kushtetues ku e ka bazuar këtë pretendim, por është shprehur se vendimi i Gjykatës së Lartë ka përkeqësuar pozitën e palës rekursuese, ndërkohë që shumica e ka përfshirë atë në standardin e gjykatës së caktuar me ligj, në drejtim të mënyrës se si Gjykata e Lartë ka ushtruar kompetencat e saj.

5. Në jurisprudencën kushtetuese parimi i mosrëndimit të pozitës së palës që vë në lëvizje gjykatën me ankim, i njohur si *reformatio in peius*, është parë vetëm në këndvështrim të garantimit të të drejtave të të pandehurit në procesin penal. Ky rregull është i parashikuar në mënyrë të shprehur në Kodin e Procedurës Penale dhe e ndalon gjykatën që të caktojë një dënim më të rëndë nga ai

i caktuar me vendimin e kundërshtuar kur apelues është vetëm i pandehuri. Gjykata ka vlerësuar se megjithëse Kushtetuta dhe KEDNJ-ja nuk e përmendin në mënyrë të shprehur këtë parim, ai në vetvete e përmban dimensionin kushtetues dhe është konsideruar si një garanci më shumë për të gjykuarin, me qëllim që ai të realizojë në mënyrë efektive të drejtën për t'u drejtuar me ankim gjykatës më të lartë, e cila merr rëndësi në një shoqëri demokratike dhe për këtë arsye askush nuk mund ta humbasë këtë përparësi. Ekzistenca e këtij parimi i jep mundësi të gjykuarve që të mos heqin dorë nga garancitë që ofron Kushtetuta, vetëm nga frika se mund të dëmtohen rëndë interesat e tyre. Parë nga ky këndvështrim, mosrespektimi i parimit *reformatio in peius* përbën njëkohësisht cenim të thelbit të një gjykimi dhe në veçanti të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së (shih vendimin 13, datë 15.4.2003, të Gjykatës Kushtetuese).

6. Në ndryshim nga legjislacioni penal, KPC-ja nuk ka parashikuar në mënyrë të shprehur një parim i tillë të zbatueshëm në procesin civil, ashtu siç ndodh me legjislacione të vendeve të tjera. Megjithatë, garantimi i të drejtave të palëve që vënë në lëvizje gjykatën me ankim realizohet përmes kufizimit që dispozitat procedurale i kanë vënë juridiksionit gjyqësor për të mos dalë tej shkaqeve dhe kërtimeve të palëve. Më konkretisht, sipas nenit 465, pika 1, të KPC-së, gjykata e apelit e shqyrtton çështjen brenda kufijve të ankimit. Në lidhje me shqyrtimin e rekursit, sipas nenit 473/a të KPC-së, Gjykata e Lartë e shqyrtton rekursin brenda kufijve të tij, përveç se kur ligji parashikon ndryshe.

7. Parimi i ndalimit të përkeqësimit të situatës së palëve nëpërmjet paraqitjes së mjetit të ankimit, pavarësisht se jo i shprehur në mënyrë eksplicite, gjen zbatim edhe në fushën civile për të njëjtat arsye si në atë penale. Ky parim përfaqëson një përbërës thelbësor të së drejtës së mbrojtjes, sepse rreziku i përkeqësimit të situatës juridike të palës që vë në lëvizje gjykatën më të lartë, do të vendoste në një disbalancë ose do të shuante çdo qëllim të palës së interesuar për t'i nënshtruar kontrollit gjyqësor më të lartë vendimin që e konsideron të paligjshëm ose të pabazuar.

8. Ndalimi i veprimit të parimit *reformatio in peius* në të drejtën civile gjen zbatim në drejtim të shqyrtimit të ankimit të vendimeve gjyqësore dhe ai



nënkupton që pushteti i gjyqtarit që shqyrton ankimin/rekursin përcaktohet në mënyrë ekskluzive nga palët që e paraqesin atë, me pasojën që në mungesë të ankimit nga njëra palë, vendimi i gjykatës më të lartë nuk mund të jetë më pak i favorshëm për palën që ka bërë ankim se sa ka qenë vendimi i kundërshtuar prej saj, pra të jetë në dëm të kësaj të fundit. Në këtë kuptim, pala që vendos të paraqesë ankim nuk mund të gjendet në një pozitë më pak të favorshme sesa do të kishte qenë po të mos e kishte ushtruar mjetin procedural, kurse mungesa e ankimit nga pala që ka fituar pjesërisht gjykimin prodhon një efekt ndalues/pengues për gjykatën më të lartë, që edhe pse nuk është “gjë e gjykuar”, në kuptim të pasojave, mbart pengesën që vendimi i kundërshtuar të ndryshohet në favor të asaj pale dhe në dëm të palës gjyqfuese pjesërisht, e cila është ajo që ka investuar gjykatën.

9. Pavarësisht parimit të kontrollit gjyqësor hierarkik brenda sistemit gjyqësor, që lejon ndryshimin e vendimit të gjykatës më të ulët nga ajo më e lartë, pra që rregullon marrëdhëniet mes gjykatave të shkallëve të ndryshme të gjykimit, dispozitat procedurale që përcaktojnë kufijtë e shqyrtimit të ankimit janë përcaktuese edhe të kufirit të gjyqtarit që e shqyrton atë (ankimin), duke përcaktuar, gjithashtu, ndalimin që ai të vendosë për çështjen me efekt përkeqësues, i cili gjen zbatim në çdo fazë gjykimi (apel dhe Gjykatë e Lartë). Pavarësisht këtij ndalimi, gjyqtari që shqyrton ankimin edhe duke lënë në fuqi vendimin e kundërshtuar, mundet që kryesisht të korrigjojë ose të ndryshojë arsyetimin e gjykatës më të ulët, për sa kohë që kjo nuk prek disponimin e asaj gjykate të pa kundërshtuar nga palët. Për sa më sipër, pushteti i gjyqtarit përcaktohet në mënyrë ekskluzive nga iniciativa e palëve në proces me pasojën që, siç është theksuar edhe më sipër, në mungesë të ankimit të palës që ka fituar gjyqin pjesërisht, vendimi i gjykatës nuk mund të jetë i disfavorshëm ndaj palës që e ka vënë atë në lëvizje me ankim në krahasim me atë çfarë ka vendosur vendimi i kundërshtuar.

10. Një qëndrim i kundërt do të binte ndesh jo vetëm me të drejtën e mbrojtjes në procesin civil, por edhe me parimin e sigurisë juridike dhe të pritshmërive të ligjshme, të cilat qëndrojnë në themel të këtij ndalimi procedural, pasi palën që ka vënë në lëvizje gjykatën me ankim kundër vendimit që ka sjellë pasoja negative për të do e ekspozonte

ndaj rrezikut që ky veprim (ushtrimi i së drejtës së ankimit) ta vendoste në një pozitë më pak të favorshme se sa do të kishte qenë nëse nuk do e kishte ushtruar atë.

11. Duke iu kthyer rrethanave të kësaj çështjeje, rezulton se kërkuesit nga viti 2006 e në vijim kanë zhvilluar disa procese gjyqësore (*shih paragrafët 3-17 të vendimit*). Procesi gjyqësor objekt i këtij gjykimi kushtetues ka të bëjë me kërkesëpadinë e datës 7.1.2012, të paraqitur nga kërkuesi Aleks Lici, me të paditur Telemah Rajdhon, Lefteria Licin dhe Këshillin e Qarkut Gjirokastrë, me objekt njohjen e pavërtetësisë së pjesshme për shkak të falsitetit të kontratës së shitjes së truallit, si dhe pavërtetësinë e pjesshme të aktit noterial që i ka dhënë formë veprimit juridik, për shkak falsiteti, për pjesën që paraqitet blerës subjekti i interesuar, si dhe pavërtetësinë e pjesshme të aktit të vlerësimit të datës 29.9.2000, për shkak falsiteti, për pjesën e shkrimit dhe nënshkrimit të subjektit të interesuar, duke kërkuar papërdorshmërinë e këtij dokumenti.

12. Gjykata e Rrethit Gjirokastrë, me vendimin nr. 21-2012-1976/978, datë 5.11.2012, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë dhe shpalljen të falsifikuar të kontratës së shitjes së truallit dhe aktit të vlerësimit. Në rigjykimin e çështjes, Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 20-2017-701/378, datë 15.9.2017, ka vendosur të lërë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë për të gjitha disponimet e tij, përveç disponimit për kërkimin për falsitet të aktit të vlerësimit dhe papërdorshmërinë e tij, duke vendosur rrëzimin e padisë për këtë kërkim.

13. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka paraqitur rekurs paditësi (kërkuesi) Aleks Lici, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe atij të apelit dhe pranimin e padisë për të gjitha kërkimet e saj. Rezulton, gjithashtu, se edhe e paditura (kërkuesja) Lefteria Lici ka paraqitur rekurs, ku ka kërkuar ndryshimin e vendimeve dhe pranimin e plotë të kërkesëpadisë, duke parashtruar të njëjtat shkaqe me ato të rekursit të palës paditëse. Ndërkohë që i padituri tjetër në proces, Telemah Rajdho, nuk ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Pavarësisht këtij fakti, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-2166 (79), datë 7.3.2022, ka vendosur të ndryshojë vendimin nr. 21-2012-1976/978, datë 5.11.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe vendimin nr. 20-2017-701/378,



datë 15.9.2017, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, duke rrëzuar praktikisht në tërësi kërkesëpadinë e paraqitur nga kërkuesi Aleks Lici.

14. Për sa është arsytuar më sipër në këtë mendim paralel, në kushtet kur kërkuesi është pala që ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë me rekurs (si pala gjyqumbëse pjesërisht), ndërkohë që i padituri Telemah Rajdho nuk ka paraqitur rekurs, kurse e paditura Lefteria Lici u është përmbajtur shkaqeve dhe pretendimeve të rekursit të kërkuetit, Gjykata e Lartë nuk mund të dispononte në këtë mënyrë, pra tej kërtimeve të rekursit, duke cenuar pozitën e kërkuetit dhe duke e vendosur atë në një situatë më të disfavorshme se sa situata që do të kishte qenë nëse nuk do e kishte kundërshtuar vendimin e gjykatës së apelit. Për më tepër, që në rastin konkret nuk duket që jemi para atyre lloj çështjesh të ligjit që merren në shqyrtim kryesisht nga Gjykata e Lartë, pra tej kërtimeve të palëve që e kanë investuar atë, gjë e cila as është vënë në diskutim dhe arsytuar prej saj.

15. Kjo mënyrë e veprimit të Gjykatës së Lartë vë në dyshim jo vetëm themelin e procesit civil në drejtim të respektimit të standardeve që kërkon e drejta për një proces të drejtë në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, por mbart edhe pasojën e krijimit të një situate pasigurie juridike për palët që investojnë gjykatën më të lartë me ankim. Për të gjitha këto argumente ishte e rëndësishme që shumica të merrte në shqyrtim këtë pretendim dhe të trajtonte në mënyrë të qartë dhe shteruese mënyrën se si zbatohet parimi i ndalimit të përkeqësimit të situatës juridike të palëve në procesin civil (*reformatio in peius*), i lidhur edhe me kufijtë e gjyqtarit të ankimit sipas parashikimeve të dispozitave procedurale civile.

Anëtarë: Marjana Semini, Ilir Toska

KËRKESË

Nr. 365/7, datë 20.6.2023

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën “Për shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Krijimi i një parkimi makinash pranë Urës së Vjetër të Goricës’”.

Subjekti kërkuet i këtij projekti është Bashkia Berat.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “truall”, sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Berat, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 853,332 (tetëqind e pesëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë dy) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Egra Ibrahim



LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI “REHABILITIM I LAGJES MUZEALE “GORICË”, BERAT

Nr.	STATUSI JURIDIK		TE DHENAT (mbi pasurinë sipas ASHK Berat)					VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT Ë PASURISË										Dokumenti i pronësisë	VLERA TOTALE (lekë)	Shënime		
	PRIVAT		Zona kadastrale		Nr. i pas.	Lloji i pas.	Sip. totale (m²)	Shpronësim tokë "arë"			Shpronësim tokë "truall"			Shpronësim ndertesë			Vegjetacioni					
	Emri Atësia Mbiemri	Statusi						Sip. (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Sip. (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Sip. (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Lloji dhe sasia				Vlera (lek)	
0	1		2	3		4	5	6	7	8	9=7*8	10	11	12	13	14	15		16	17	18=9+12+15	Seksioni D -E i kartelës
1	SHTET			8502	Vol 26 f. 21	4/426	Truall	5.3				5.3	0	0						Kartela e regj. dhe hartë treg.	0	Kjo pasuri është e okupuar nga Mandi Vangjel Xhamo
2	Pavlo Kristaq Kusta		Pronar	8502	Vol 15 f. 139	4/307	Truall	20.4				20.4	4183	85333						Kartela e regj. dhe hartë treg.	85333	
3	Filip dhe Thimi Anastas Sinjari		Pronar	8502	Vol 15 f. 138	4/308	Truall	183.6				183.6	4183	767999						Kartela e regj. dhe hartë treg.	767999	
4	SHTET			8502	Vol 26 f. 16	4/421	Truall	100.7				100.7	0	0						Kartela e regj. dhe hartë treg.	0	Ka një ndërtim të paligjshëm
5	SHTET			8502	Vol 26 f. 18	4/423	Truall	17.9				17.9	0	0						Kartela e regj. dhe hartë treg.	0	Ka një ndërtim të paligjshëm
6	SHTET			8502	Vol 25 f. 206	4/21	Truall	1561.3				1561.3	0	0						Kartela e regj. dhe hartë treg.	0	
7	SHTET			8502	Vol 33 f. 81	4/129	Shesh	1164.2				594.4	0	0						Kartela e regj. dhe hartë treg.	0	
8	SHTET			8502	Vol 27 f. 52	4/18	Shesh	620.1				620.1	0	0						Kartela e regj. dhe hartë treg.	0	
9	SHTET			8502	Vol 26 f. 17	4/422	Truall	81				81	0	0						Kartela e regj. dhe hartë treg.	0	
10	SHTET			8502	Vol 26 f. 27	4/451	Truall	452				32.3	0	0						Kartela e regj. dhe hartë treg.	0	
	TOTAL											204.00	4183	853332							853332	

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 433, datë 7.2.2023, vendosi shpalljen e vdekjes së shtetasit Viktor Sharko, i datëlindjes 3.1.1932, me atësi Theodhor dhe amësi Urania, dhe caktimin si datë të vdekjes datën 1.8.2007.

KËRKESË

Shtetasi Agim Dibra kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë shpalljen të zhdukur të shtetases Leme Dibra, e datëlindjes 11.10.1915, banuese në Tiranë.

KËRKUES
Agim Dibra

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006